



RAPORT AKADEMIK

2024-2025

PËRMBAJTJA

Hyrje	3
Pjesa I: Veprimtaria Akademike e Shkollës së Magjistraturës	4
Kreu I. Formimi Fillestar 2024-2025	5
1.1 Objektivat e Programit të Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës.....	6
1.2 Viti i Parë i Formimit Fillestar	7
1.3 Viti i Dytë i Programit të Formimit Fillestar.....	17
1.4 Viti i Tretë Akademik 2024-2025.....	22
1.5 Përmbushja e objektivave mësimore.....	25
1.6 Staf i pedagogjik.....	26
1.7 Konkursi i Pranimit 2025-2026.....	27
1.8 Aktivitete të ndryshme në kuadër të Programi të Formimit Fillestar.....	35
1.9 Marrëdhëniet e bashkëpunimit me KLGJ dhe KLP.....	37
Kreu II. Formimi Vazhdues 2024-2025	39
2.1 Objektivat e Programit të Formimit Vazhdues në Shkollën e Magjistraturës.....	40
2.2 Dinamika e pjesëmarrjes në trajnime (2024–2025).....	41
2.3 Analiza e nevojave për trajnim dhe miratimi i kalendarit të aktiviteteve trajnuese.....	41
2.4 Metodologjia.....	43
2.5 Projekti i Binjakëzimit “Forcimi i efikasitetit, integritetit dhe profesionalizmit të sistemit të drejtësisë duke përmirësuar kapacitetet e Shkollës shqiptare të Magjistraturës”	44
2.6 Rritja e eficiencës së trajnimit vazhdues, forcimi i bashkëpunimit me gjykatat dhe prokuroritë, si dhe forcimi i rolit dhe kontributit të magjistratit.....	44
2.7 Realizimi i kalendarit të trajnimeve.....	45
2.8 Temat e trajnimeve.....	53
2.9 Trajnime trajnerësh.....	55
2.10 Ekspertiza.....	58
2.11 Pjesëmarrja e gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve të tjerë të së drejtës.....	60
2.12 Roli i Sektorit të Formimit Vazhdues.....	61
Kreu III. Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë	65
3.1 Aktivitete të rëndësishme gjatë vitit akademik 2024-2025.....	66
3.2 Perspektiva.....	71
Kreu IV. Publikimet dhe puna kërkimore shkencore	72
4.1 Raportim mbi ecurinë e publikimeve dhe kërkimit shkencor për vitin akademik 2024-2025.....	73
4.2 Puna kërkimore shkencore.....	78
4.3 Biblioteka.....	78
Kreu V. Zhvillimi i Teknologjisë së Informacionit	80
5.1 Zhvillimi dhe përdorimi i platformës digjitale SMVSHM.....	81
5.2 Implementimi i Shërbimit Microsoft 365.....	81
5.3 Digjitalizimi i Mësimdhënies.....	82
5.4 Faqja Eëb, mjete zyrtar i informimit.....	83

5.5 Komunikimi dhe transparenca nëpërmjet rrjeteve sociale.....	83
5.6 Komunikimi nëpërmjet forumit të Shkollës së Magjistraturës.....	84
5.7 Teknologjia e Informacionit në funksion të sigurisë.....	84

Pjesa II: Prioritetet e Shkollës për vitin e ri akademik 2025-2026.....	86
2.1 Për Programin e Formimit Fillestar.....	87
2.2 Për Programin e Formimit Vazhdues.....	89
2.3 Për Projektet dhe Marrëdhëniet me Jashtë.....	92
2.4 Publikimet dhe puna kërkimore shkencore 2024-2025.....	92
2.5 Për avancimin e Teknologjisë së Informacionit.....	94

SHKURTIME

Shkolla e Magjistraturës	SHM
Këshilli i Lartë Gjyqësor	KLQJ
Këshilli i Lartë i Prokurorisë	KLP
Prokuroria e Përgjithshme	PP
Ministria e Drejtësisë	MD
Avokati i Përgjithshëm i Shtetit	APSH
Inspektori i Lartë i Drejtësisë	ILD
Gjykata e Lartë	GJL

HYRJJE

Shkolla e Magjistraturës, gjatë vitit akademik 2024-2025, ka realizuar me sukses programin mësimor për Formimin Fillestar për tre vite mësimore, përgatitur 184 kandidatë, nga të cilët 98 kandidatë për gjyqtarë, 77 kandidatë për prokurorë, 9 ndihmës ligjorë, që do t'i bashkohen sistemit gjyqësor në vitet në vijim. Në vitin 2025 u diplomuan 42 gjyqtarë dhe 26 prokurorë.

Pas procesit të rekrutimit të organizuar në prill 2025, në Shkollë nisën Programin e Formimit Fillestar 29 kandidatë për gjyqtarë, prokurorë, avokat shteti, këshilltar dhe ndihmës ligjorë.

Në Programin e Formimit Vazhdues gjatë vitit akademik 2024 -2025, 811 subjekte të trajnimit kanë marrë pjesë të paktën një herë në veprimtaritë trajnuese të Shkollës së Magjistraturës, duke treguar përfshirje të gjerë dhe interes të vazhdueshëm për zhvillim profesional. Sistemi i trajnimeve sipas moduleve solli një përmirësim të ndjeshëm në mënyrën e organizimit të trajnimeve dhe vlerësimin e tyre. Metodologjia interaktive e trajnimit, bazuar në standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të shkollave homologe, rriti pjesëmarrjen aktive të subjekteve të trajnimit dhe pasuroi debatin në aktivitetet. Në aktivitetet trajnuese një rol të rëndësishëm ka luajtur edhe bashkëpunimi me partnerët kombëtarë e ndërkombëtarë, të cilët kanë mbështetur ekspertizën e Shkollës dhe kanë bashkëpunuar në organizim apo logjistikë.

Një hapësirë të rëndësishme përgjatë vitit akademik 2024-2025, Shkolla i ka kushtuar analizës së tre komponentëve kryesorë të aktivitetit të saj: provimit hyrës, Programit të Formimit Fillestar dhe Programit të Formimit vazhdues. Kjo analizë u realizua së bashku me Projektin e Binjakëzimit të Bashkimit Europian që nisi të zhvillohet në Shkollë prej muajit qershor 2024. Projekti “Forcimi i efencës, integritetit dhe profesionalizmit të sistemit të drejtësisë përmes rritjes së kapaciteteve të Shkollës së Magjistraturës”, me anë të cilësisë së lartë të ekspertizës që ka ofruar nga tre shkollat homologe, Shkolla franceze, shkolla holandeze dhe shkolla italiane, ka thelluar reflektimin mbi çështje thelbësore të Shkollës dhe ka arritur të japë produkte me ndikim të lartë. Reformimi i kurikulës së Programit të Formimit Fillestar, ndryshimi i qasjes ndaj trajnimit të kandidatëve, përmirësimi i metodologjisë së trajnimit dhe zbatimi i metodologjisë së re, ka qenë një punë tejet voluminoze dhe transformuese.

Gjithashtu, ndjekja e objektivave strategjike të përcaktuar në Strategjinë e Shkollës për vitet 2024-2028 dhe ndjekja e detyrimeve që burojnë nga procesi i negociatave për anëtarësim në Bashkimin Europian krijoi mundësinë për të parë të ridimensionuar Shkollën në vitet që do të vijnë dhe për të nisur procese të rëndësishme përmirësuese të aktivitetit të Shkollës.

Ky raport synon të japë një informacion të detajuar, të qartë e të kuptueshëm për çdo subjekt që është i interesuar të njohë e analizojë aktivitetin e saj. Informacioni është i shoqëruar me të dhëna statistikore dhe pasqyrojnë ecurinë e veprimtarisë akademike të Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2024-2025.

PJESA E PARË

Veprimtaria akademike e Shkollës së Magjistraturës

Kreu 1

Formimi Fillestar 2024-2025

KREU I PROGRAMI I FORMIMIT FILLESTAR

1.1 OBJEKTIVAT E PROGRAMIT TË FORMIMIT FILLESTAR NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS

Objektivat kryesore të Programit të Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës:

1. Përgatitja profesionale e kandidatëve për magistratë (gjyqtarë e prokurorë), këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë

- T'i pajisë ata me njohuri të thelluara teorike dhe aftësi praktike për të ushtruar funksionin në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe profesionale.

2. Integrimi i teorisë me praktikën gjyqësore

- Të zhvillojë te kandidatët aftësinë për të zbatuar në mënyrë kritike dhe efikase normat juridike në situata konkrete.

3. Zhvillimi i kulturës gjyqësore dhe etikës profesionale

- Të kultivojë te kandidatët parimet themelore të etikës gjyqësore, të etikës së prokurorit, dhe etikës në tërësi të nëpunësit në shërbimin gjyqësor civil, integritetit dhe përgjegjshmërisë.

4. Përgatitja për vendimmarrje të arsyetuar dhe të drejtë

- T'i aftësojë kandidatët të ndërtojnë vendime/projektakte të argumentuara ligjërisht, të strukturuar qartë dhe të bazuara në ligj.

5. Zhvillimi i mendimit kritik dhe aftësive për arsyetim ligjor

- Të nxisë te kandidatët aftësinë për analizë të thelluar të çështjeve juridike dhe zgjidhjen e tyre me logjikë të qartë ligjore.

6. Zhvillimi i aftësive: komunikimi dhe menaxhimi në procesin gjyqësor

- Të përgatisë kandidatët për të komunikuar në mënyrë të qartë, etike e profesionale me palët, kolegët dhe publikun.

7. Ndërgjegjësimi për të drejtat e njeriut dhe standardet ndërkombëtare

- Të sigurohet që kandidatët të jenë të aftë të njohin dhe respektojnë standardet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së.



1.2 VITI I PARË I FORMIMIT FILLESTAR

Viti akademik 2024-2025 filloi më 7 tetor 2024.



Ky vit u ndoq nga kandidatët e profilit gjyqtar, prokuror, ndihmës ligjor, si dhe nga subjektet e rivlerësimit, të cilët ndoqën programin e posaçëm të formimit në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar.

Mësimi u organizua në tri klasa, me një mesatare prej rreth 20 kandidatësh për klasë, duke siguruar kushte të përshtatshme për zhvillimin efektiv të procesit mësimor. Orët e mësimit u zhvilluan në mjediset e Shkollës së Magjistraturës nga e hëna deri të premten, sipas orarit të përcaktuar në fillim të vitit akademik.


TË DHËNA STATISTIKORE

Raporti gjinor dhe përbërja e kandidatëve në Programin e Formimit Fillestar (2024–2025)

Në të tria vitet e Programit të Formimit Fillestar për vitin akademik 2024–2025, shpërndarja gjinore e kandidatëve paraqitet si më poshtë:

- Femrat përbëjnë rreth 65% të numrit total të kandidatëve.
- Meshkujt përfaqësojnë afërsisht 32% të kandidatëve.
- Subjektet e rivlerësimit, të cilët janë të gjithë meshkuj, përbëjnë rreth 3% të totalit të kandidatëve.

Raporti gjinor dhe përbërja e kandidatëve në Programin e Formimit Fillestar (Viti akademik 2024–2025)



Analiza e shkollimit të kandidatëve të vitit akademik 2024–2025

Bazuar në të dhënat e kandidatëve për magjistratë, rezulton se nga numri i përgjithshëm i kandidatëve që ndjekin Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2024–2025:

- 154 kandidatë kanë përfunduar studimet e ciklit të parë dhe të dytë në fakultete publike të drejtësisë në Shqipëri.
- 17 kandidatë kanë kryer studimet në institucione private të arsimit të lartë në Shqipëri.
- 5 kandidatë janë diplomuar në universitete të huaja në fushën e drejtësisë.

Këto të dhëna pasqyrojnë një orientim të qartë të shumicës së kandidatëve drejt institucioneve publike shqiptare për formimin e tyre juridik.



1.2.1 KANDIDATËT PËR MAGJISTRATË (PROFILI GJYQJAR DHE PROKUROR)

Në përfundim të procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë për vitin akademik 2024-2025, statusin e kandidatit e fituan:

- 19 kandidatë për gjyqtarë;
- 26 kandidatë për prokurorë;
- 9 kandidatë për ndihmës ligjor.

Lëndët e vitit të parë:

Me vendimin nr.34, datë 27.9.2024, “Për miratimin e planeve mësimore në Programin e Formimit Fillestar për vitin akademik 2024-2025”, vendimin nr. 35, datë 27.9.2024, “Për miratimin e Programeve mësimore në Programin e Formimit Fillestar për vitin akademik 2024-2025”, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës miratoi programin dhe planin mësimor të Formimit Fillestar për vitin e parë akademik 2024-2025, ku parashikohej zhvillimi i njëzet lëndëve, të grupuara në lëndë të grupit të parë dhe lëndë të grupit të dytë, si më poshtë:

Nr.	GRUPI I PARË	Nr.	GRUPI I DYTË
1.	E drejta civile	12.	E drejta e punës dhe e drejta e sigurimeve shoqërore
2.	E drejta penale	13.	E drejta ndërkombëtare private
3.	Procedura civile	14.	E drejta tatimore-financiare
4.	Procedura penale	15.	Administrimi i gjykatave dhe prokurorive. Menaxhimi i kohës gjyqësore
5.	E drejta kushtetuese dhe të Drejtat e Njeriut	16.	Pronësia intelektuale
6.	E drejta e BE-së	17.	Ndërmjetësimi, arbitrazhi
7.	E drejta administrative	18.	E Drejtë e Mjedisit
8.	Arsyetim dhe shkrim ligjor 1.Pjesa e Përgjithshme 2.Pjesa e posaçme për gjyqtarë dhe prokurorë 2.1 Pjesa e posaçme për Ndihmësit Ligjor	19.	E Drejta Penale Ndërkombëtare
9.	Etika profesionale	20.	I mituri dhe viktima
10.	E drejta familjare		
11.	E drejta tregtare dhe e kompanive		

Me vendimin nr.36, datë 27.9.2024, “Për miratimin e listës së pedagogëve të jashtëm, pedagogëve në dispozicion, specialistëve dhe asistent pedagogëve të Programit të Formimit Fillestar për vitin akademik 2024 - 2025” Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës miratoi trupën akademike për vitin akademik 2024-2025.

Zhvillimi i provimeve dhe vlerësimi i kandidatëve

Skema e vlerësimit të kandidatëve për magjistratë gjatë vitit të parë

Vlerësimi i kandidatëve për magjistratë gjatë vitit të parë të studimeve është realizuar sipas skemës së mëposhtme:

- Vlerësimi i vazhdueshëm gjatë gjithë vitit akademik;
- Provim përfundimtar i lëndës.

Totali i pikëve të vlefshme për vlerësimin e kandidatëve në çdo lëndë në fund të vitit ose semestrit ishte 100 pikë, të ndara si më poshtë:

- 40 pikë për vlerësimin e vazhdueshëm vjetor;
- 60 pikë për provimin përfundimtar.

Përjashtim nga kjo skemë bën lënda “Arsyetim dhe shkrim ligjor”, ku vlerësimi ishte ndarë në mënyrë të barabartë: 50 pikë për vlerësimin e vazhdueshëm dhe 50 pikë për provimin përfundimtar.

Kufijtë minimalë dhe maksimalë të pikëve për secilën pjesë të vlerësimit janë përcaktuar për çdo lëndë, në varësi të natyrës dhe specifikave të saj. Këto limite janë bërë të njohura në programet përkatëse të lëndëve përpara fillimit të vitit akademik.

Mënyra dhe skema e vlerësimit, si dhe shpërndarja e pikëve për secilën pjesë të tij, u janë komunikuar kandidatëve nga pedagogët përgjegjës në fillim të çdo kursi apo lënde, në përputhje me kriteret e miratuara të vlerësimit.

Provimet e vitit të parë u realizuan në tri faza: në muajin shkurt, prill dhe maj-qershor. Me urdhrin nr. 246, datë 20.12.2025, “Për ngritjen e komisioneve të provimeve të lëndëve semestrale për kandidatët për magjistratë dhe kandidatët për ndihmës ligjor për vitin akademik 2024-2025”, u ngritën komisionet e provimeve për lëndët e semestrit të parë: pronësi intelektuale, e drejtë e mjedisit, administrimi i gjykatës dhe prokurorive. Menaxhimi i kohës gjyqësore, dhe i mituri dhe viktima.


Me urdhrin nr. 67, datë 10.3.2025, “Për ngritjen e komisioneve të lëndëve semestrale për kandidatët për magjistratë dhe kandidatët për ndihmës ligjor për vitin akademik 2024-2025”, u ngritën komisionet e provimeve për lëndët semestrale: e drejtë e BE-së, e drejtë tatimore dhe doganore, e drejtë e punës dhe sigurimet shoqërore.

Me urdhrin nr. 88, datë 10.4.2025, “Për ngritjen e komisioneve të provimeve të lëndëve vjetore dhe semestrale për kandidatët për magjistratë dhe kandidatët për ndihmës ligjor për vitin akademik 2024-2025”, për 13 lëndë: e drejtë ndërkombëtare private, etikë profesionale, e drejtë penale, procedurë penale, e drejtë penale ndërkombëtare, e drejtë familjare, e drejtë kushtetuese, e drejtë administrative, e drejtë civile, procedurë civile, e drejtë tregtare dhe e kompanive, ASHL, ndërmjetësim arbitrazhi.


Tabela nr. 1: Lëndët me rezultatet mesatare më të larta për të gjithë kandidatët.

Renditja	Lënda	Nota mesatare
1	Ndërmjetësim & Arbitrazh	96.04
2	Tatim, Financiare	94.85
3	E Drejta e Mjedisit	93.67
4	E Drejta Ndërkombëtare Private	93.37
5	Administrimi i Gjykatave	92.48
6	E Drejta e BE-së	92.48
7	E Drejta Familjare	91.85
8	Etika Profesionale	91.57
9	E Drejta Tregtare	90.59
10	E Drejta e Pronësisë Intelektuale	89.52

Të dhënat tabelare në formë grafike:



Grafikët më poshtë tregojnë mesataren e notave për çdo lëndë për kandidatët për magjistratë të profilin prokuror dhe gjyqtar.



Të dhënat tregojnë se mesatarja e përgjithshme e të gjitha lëndëve për kandidatët për gjyqtarë është 88.6 pikë, ndërsa për kandidatët për prokurorë është 88.1 pikë.

Rezultatet më të larta si për kandidatët për prokuror ashtu edhe për kandidatët për gjyqtar janë në lëndët: “Ndërmjetësim dhe arbitrazh”, “E drejtë tatimore financiare”, “E drejtë e BE-së” dhe “E drejtë familjare”.

Lëndët në të cilat të dyja profilet rezultojnë me mesataren më të ulët të pikëve janë “E drejta penale” dhe “E drejta administrative”.

Marzhet e vlerësimit

Vlerësimi maksimal i vitit të parë për kandidatët për magjistratë për vitin akademik 2024-2025 është 2550 pikë.

Vlerësimi me shkallë i kandidatëve për magjistratë është:

Niveli “Shkëlqyeshëm” është 100 (njëqind) pikë;

Niveli “Shumë mirë” është 90-99 (nëntëdhjetë deri nëntëdhjetë e nëntë) pikë;

Niveli “Mirë” është 70-89 (shtatëdhjetë deri tetëdhjetë e nëntë) pikë;


Niveli “Mjaftueshëm” është 60-69 (pesëdhjetë deri gjashtëdhjetë e nëntë) pikë.

Rezultatet e kandidatëve për magjistratë në përfundim të vitit të parë të studimeve kanë qenë të kënaqshme, duke treguar një nivel të mirë përgatitjeje akademike dhe profesionale. Vlerësimet përfundimtare janë dhënë në bazë të performancës gjatë vitit akademik dhe rezultateve të provimeve përfundimtare.

Nga 46 kandidatë që u futën në provime:

- 13 kandidatë (28.26%) u vlerësuan me “Shumë mirë”;
- 33 kandidatë (71.73%) u vlerësuan me “Mirë”;
- Asnjë kandidat nuk është vlerësuar “Mjaftueshëm”.

Niveli i vlerësimeve të kandidatëve për magjistratë në përfundim të vitit të parë




TË DHËNA STATISTIKORE

Raporti femra – meshkujt midis kandidatëve për magjistratë

Në këtë vit akademik, Shkolla e Magjistraturës ka pritur 46 kandidatë për magjistratë, të cilët janë ndarë në dy profile: gjyqtarë dhe prokurorë. Nga 46 kandidatët gjithsej: 27 janë femra, që përfaqësojnë rreth 59% të totalit; 19 janë meshkuj, që përfaqësojnë rreth 41% të totalit. Kandidatët ndahen në dy kategori kryesore: 26 kandidatë për prokurorë; 20 kandidatë për gjyqtarë

Profil: Prokuror: 14 femra (54%) dhe 12 meshkuj (46%)

Profil: Gjyqtar: 13 femra (65%) dhe 7 meshkuj (35%)



1.2.2 KANDIDATËT PËR NDIHMËS LIGJOR

1. Përshkrimi i procesit të vlerësimit në Programin e Formimit Fillestar

Gjatë vitit të parë kandidatët për ndihmës ligjor u vlerësuan për 11 lëndë kryesore me koeficient vështirësie 1.5 dhe 9 lëndë të grupit të dytë me koeficient vështirësie 1.


Vlerësimi përfundimtar për kandidatët për ndihmës ligjor në Programin e Formimit Fillestar bazohet në:

- a) Vlerësimin e vazhdueshëm gjatë gjithë vitit akademik;
- b) Provimin përfundimtar të çdo lënde;
- c) Provimin përfundimtar me raste praktike.

Provimi përfundimtar me rastet praktike për kandidatët për ndihmës ligjorë u zhvillua në datën 1 korrik 2025, pasi kandidatët kishin dhënë të gjitha provimet e tjera. Provimi u zhvillua me shkrim, në formë të sekretuar dhe zgjati 4 orë. Teza përmbante katër raste praktike, të ndara sipas fushave:

1. E drejta private (civile, familjare, tregtare, e punës) dhe e drejta procedurale civile;
2. E drejta penale dhe procedurale penale;
3. E drejta administrative materiale dhe procedurale administrative;
4. E drejta publike (kushtetuese, të drejtat e njeriut, ndërkombëtare, legjislacioni i BE-së, etj.).

Provimi u vlerësua nga një komision me katër anëtarë, të përbërë nga pedagogë të brendshëm dhe të jashtëm të Shkollës së Magjistraturës, i ngritur me urdhrin nr. 88, datë 10.4.2025. Pas përfundimit të korrigjimit, shpallja e rezultateve u krye në bazë të numrave të sekretimit. Hapja e zarfeve me emrat e kandidatëve u bë në prani të tyre, në mënyrë transparente. Kandidatët patën mundësi të verifikonin përgjigjet e tyre në mjediset e Shkollës, pa të drejtë fotokopjimi apo marrjeje të fletëve të provimit.



Në përfundim të këtij procesi rezultuan se 5 kandidatë nuk arritën të merrnin 70 pikë nga 100 të mundshmet, minimumi i nevojshëm nga ligji për t'u renditur në listën e fituesve. Në këto

kushte, për të mos penguar procesin e emërimit të tyre, bazuar në rregulloren e brendshme të Shkollës së Magjistraturës, kandidatët iu nënshtruan ridhënies së provimit në datën 15 korrik 2025. Pas ridhënies së provimit edhe këta kandidatë e kaluan pragun e pikëve minimale. Vlerësimi maksimal i vitit të parë ishte 2550 pikë, nga të cilat 1650 lëndët kryesore dhe 900 pikë lëndët e grupit të dytë. Kandidati që u rendit i pari kishte 2198 pikë gjithsej, ndërsa kandidati që u rendit i fundit kishte 2110.99 pikë nga 2550 pikë gjithsej. Pikët më të larta të marra në provimin përfundimtar ishin 77.5 pikë.

Pas përfundimit të procesit, Këshilli Pedagogjik miratoi vlerësimet përfundimtare të kandidatëve për ndihmës ligjorë. Rezultatet, pas miratimit nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës me vendimin nr. 23, datë 21.7.2025, “Për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për ndihmës ligjor për vitin akademik 2024-2025”, iu përcollën Këshillit të Lartë Gjyqësor, për efekt të emërimit të tyre në detyrën e ndihmësit ligjor pranë gjykatave të apelit, në përputhje me ligjin nr. 98/2016.

TË DHËNA STATISTIKORE:

Numri i ndihmësve ligjorë: **9**

Mesatarja e përgjithshme e grupit: **rreth 80.88%**

Shkalla e vlerësimit: të gjithë në nivelin “*Mirë*”

Shtirja e rezultateve: **nga 78.47% deri në 82.71%.**

Raporti gjinor: **3 meshkuj dhe 6 femra**


Vlerësim i përgjithshëm: Grup homogjen me performancë të qëndrueshme dhe dallime të vogla ndërmjet tyre.

Raporti Gjinor i Kandidatëve për Ndihmës Ligjor (Brezi 2024–2025)

Raporti gjinor i kandidatëve për ndihmës ligjor për vitin akademik 2024–2025:

- 66.7% femra
- 33.3% meshkuj

Kjo tregon një numër më të madh të femrave në këtë brez.



1.2.3 SUBJEKTET E RIVLERËSIMIT

Subjektet e rivlerësimit, të cilët sipas vendimeve të ndërmjetme: vendimit nr. 46, datë 2.11.2023, vendimit nr. 13, datë 5.4.2024; nr. 4 vendimi, datë 10.5.2024; vendimit nr. 38, datë 25.7.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ku ishte vendosur: “Pezullimi nga detyra për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimi për të ndjekur programin e trajnimit sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës”, ndoqën rregullisht për një periudhë 9-mujore programin e formimit fillestar të miratuar me vendimin nr. 37 dhe nr. 38, datë 27.9.2025 të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.


Subjektet e rivlerësimit në vitin akademik 2024-2025 ishin katër: tre prokurorë dhe një gjyqtar. Ata iu nënshtruan provimeve sipas lëndëve të përcaktuara në programin dhe planin mësimor të subjekteve të rivlerësimit.

Vlerësimi i subjekteve të rivlerësimit u bë sipas skemës:

- a) Vlerësimi i vazhdueshëm gjatë gjithë vitit akademik;
- b) Provimi përfundimtar i lëndës;
- c) Provimi me raste praktike, i cili u zhvillua sipas parashikimeve të nenit 45/1 të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës.

Këshilli Pedagogjik i Shkollës së Magjistraturës miratoi rezultatin e subjekteve të rivlerësimit, të cilët u certifikuan, së bashku me raportin përfundimtar edhe nga ana e Këshillit Drejtues me vendimin nr.20, datë 14.7.2025, “Për miratimin e vlerësimit të subjekteve të rivlerësimit për vitin akademik 2024-2025”. Në bazë të rezultateve të arritura nga subjektet, të cilët morën mbi 70% të pikëve në provimin përfundimtar, arritën të kalojnë mangësitë e parashtruara në Vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Në vijim, vendimi i Shkollës së Magjistraturës, iu përcoll, sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Vëzhguesve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Grafiku i përqindjes individuale të katër kandidatëve



1.3 VITI I DYTË I PROGRAMIT TË FORMIMIT FILLESTAR

Viti i dytë akademik u ndoq nga 37 kandidatë për gjyqtarë dhe 25 kandidatë për magjistratë, profili prokuror. Gjithsej, 62 kandidatë.

Në fillim të vitit të dytë akademik 2024-2025, trupa pedagogjike e Shkollës së Magjistraturës zhvilloi një takim me kandidatët për magjistratë të vitit të dytë. Gjatë takimit u sqarua mënyra e realizimit të dosjeve individuale në përfundim të praktikës në institucione, format e vlerësimit të tyre, si dhe rëndësia e kalimit nga raportimi i thjeshtë drejt ndërtimit të një dosjeje të plotë, e cila do të përmbante akte konkrete dhe memon e shkruar dhe konceptuar nga vetë kandidatët. Ky ndryshim synonte një angazhim më të thelluar profesional dhe reflektim praktik të njohurive të fituara gjatë formimit në Shkollën e Magjistraturës.



Programi i vitit të dytë kishte një ngarkesë mësimore prej 1188 orësh, me shumë komponentë praktikë. Vetëm 48 orë ishin me natyrë formuese me karakter të përgjithshëm dhe të specializuar në drejtim të rritjes së dijeve dhe aftësimit sa më praktik të kandidatëve. Pjesa tjetër e ngarkesës ishte praktikë vëzhguese, hulumtuese, krijuese, debatuese, diskutuese etj.: 896 orë praktikë vëzhguese në organet e drejtësisë dhe institucione të tjera; 292 orë të formimit praktik në një ditë në javë në shkollë në semestrin e parë dhe dy ditë në javë në shkollë dhe/ose online në semestrin e dytë.

Gjatë vitit akademik 2024-2025 kandidatët zhvilluan 5 kurse:

1. Kurse me natyrë formuese me karakter të përgjithshëm:

- (1) Psikologjia e komunikimit dhe emocionet;
- (2) Anglishtja ligjore.

2. Kurse me natyrë praktike:

- (1) Klinika ligjore dhe shkencore;
- (2) Kriminalistika;
- (3) Aftësitë e prokurorit për paraqitjen e çështjeve në gjykatë.

Stazhi paraprofesional, sipas fushave: civile; penale; administrative

Praktika paraprofesionale në Gjykatë e Prokurori u zhvillua 4 (katër) ditë semestrin e parë dhe 3 (tre) ditë semestrin e dytë. Institucionet ku u zhvillua praktika ishin: a) Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë; b) Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe c) Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. *Për çdo periudhë praktike kandidatët hartuan 2 (dy) memo argumentuese, 1*

(një) procedurale dhe 1 (një) memo materiale. Gjithsej, përgjatë praktikës paraprofesionale ata hartuan 8 (tetë) memo argumentuese.

Gjyqet imituese

Gjatë vitit akademik 2024-2025 u organizuan 6 gjyqe imituese për 6 grupe, pra 36 gjyqe imituese gjithsej.

Kandidatët përgatitën aktet ligjore të nevojshme për realizimin e gjyqeve imituese, si dhe raportimeve për praktikën gjyqësore. Çdo gjyq imitues kishte fazën e tij përgatitore të akteve nga kandidatët. Aktet u përgatitën në mënyrë të pavarur nga kandidatët sipas ndarjes së punës në grupe dhe u diskutuan me pedagogët përgjegjës të praktikës paraprofesionale. Në auditor u nxorën konkluzionet e versioneve finale të tyre. Në rubrikën “Debat” kishte trajtime nga praktika gjyqësore, si dhe përgatitje të dosjeve për gjyqin imitues në një ose disa çështje konkrete gjyqësore, të tilla si për shembull: nga fusha e sigurimeve, e kriminalistikës, e mjekësisë ligjore, e kontabilitetit, e prokurimeve etj. Një kurs përfshin më shumë se 2-4 çështje, në varësi të problematikës që lidhet me praktikën gjyqësore.



Pamje nga gjyqet imituese, viti i dytë 2024-2025

Klinika ligjore

Klinika Ligjore dhe Shkencore mbetet edhe këtë vit akademik një nga disiplinat kryesore të programit mësimor praktik të Shkollës së Magjistraturës.

Ky kurs synon ofrimin e konsulencës juridike të thelluar në formën e një pune kërkimore-shkencore për institucionet kryesore të sistemit të drejtësisë në Shqipëri, si: Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë, Prokuroria e Përgjithshme, gjykatat e posaçme dhe të specializuara etj.

Çështjet që trajtohen janë komplekse dhe kërkojnë qasje krahasuese dhe interpretim të jurisprudencës ndërkombëtare dhe asaj të GJEDNJ-së, duke reflektuar edhe përvojat e shteteve të tjera në çështje të ngjashme.

Produkti final i këtij kursi janë Memot Ligjore, të cilat u hartuan nga studentët e ndarë në 12 grupe (me nga pesë dhe gjashtë kandidatë). Ata iu përgjigjën pyetjeve të ardhura nga Gjykata Kushtetuese (2 pyetje), Gjykata e Lartë (6 pyetje) dhe Prokuroria e Përgjithshme (4 pyetje), nën drejtimin e pedagogëve të klinikës ligjore. Pyetjet i përkisnin gjykimit kushtetues,

administrativ, civil, penal dhe procedural penal. Memot e përfunduara iu dërguan edhe institucioneve kërkuuese dhe përfaqësojnë një kontribut të drejtpërdrejtë në mbështetje të praktikës gjyqësore dhe vendimmarrjes së tyre.



Vlerësimi gjatë vitit të dytë

Gjatë vitit të dytë vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme disa komponentë:

- I. Komponenti i parë lidhet me kurset në funksion të formimit të përgjithshëm dhe kurset e specializuara praktike:

- 1) **Vlerësimi i kurseve me formim të përgjithshëm:** psikologjia e komunikimit dhe emocionet, si dhe anglishtja ligjore u bë sipas mënyrës “kalon”/“nuk kalon”.
- 2) **Vlerësimi i kursit me karakter të specializuar praktik “Kriminologjia”** është 100 pikë, me koeficient vështirësie 1.
- 3) **Vlerësimi i kursit me karakter të specializuar praktik “Klinika Ligjore”** është 100 pikë, me koeficient vështirësie 1.5.
- 4) **Vlerësimi i kursit me karakter të specializuar praktik “Aftësitë e prokurorit për paraqitjen e çështjes në gjykatë”** u bë me anë të dosjes që kandidatët për prokuror dorëzuan në përfundim të praktikës paraprofesionale. Pra, nuk kishte vlerësim më vete.

Pikët maksimale të komponentit të parë të vitit të dytë janë 250 pikë.

- II. Komponenti i dytë i vlerësimit lidhet me formimin e aftësive praktike në drejtimet e mëposhtme:

1) **Mënyra e vlerësimit të gjyqeve imituese, diskutimeve dhe debateve lidhur me çështje të praktikës gjyqësore, si dhe me dosjeve të përgatitura gjatë vitit.** Realizimi i gjyqeve imituese, debateve, dosjeve të përgatitura dhe vlerësimi, u bë nga pedagogët përgjegjës në Shkollë. U vlerësua me 100 pikë me koeficient vështirësie 2.4 (dy pikë katër).

2) **Mënyra e vlerësimit të praktikës në gjykata dhe prokurori**

2.1 **Vlerësimi nga përgjegjës/përgjegjësit e stazhit paraprofesional nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve**

2.1/a Praktika për kandidatët gjyqtarë vlerësohet nga mentorët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Dhoma Civile + Dhoma Penale + Gjykata Administrative e shkallës së parë nga 150 pikë secili mentor respektiv. Totali i vlerësimit nga mentorët në fund të praktikës është 450 pikë me koeficient vështirësie 1.5 (një pikë pesë) dhe në total me 675 pikë.

2.1/b Praktika për kandidatët për prokuror vlerësohet nga mentorët e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me 250 pikë, nga mentorët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Dhoma Penale me 150 pikë dhe nga mentorët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Dhoma Civile me

50 pikë. Totali i vlerësimit nga mentorët në fund të praktikës ishte 450 pikë me koeficient vështirësie 1.5 (një pikë pesë) dhe në total 675 pikë.

2.2 Vlerësimi përmes dosjes, “portofolit”, të kandidatit (akteve dhe memove) – risia e këtij viti akademik

Në vend të raporteve kandidatët për magjistratë të vitit të dytë realizuan 4 dosje për çdo profil. Kandidatët për gjyqtar dorëzuan katër dosje: dy dosje civile, një dosje penale dhe një dosje administrative. Kandidatët për prokuror dorëzuan katër dosje: tre dosje penale dhe një dosje civilo-administrative. Realizimi i dosjes kishte lidhje me periudhën e praktikës. P.sh. dosja e parë civile për kandidatët për gjyqtarë përmbledhonte aktet dhe memot e realizuara gjatë 5 javëve të para të zhvillimit të praktikës paraprofesionale në gjykatën civile dhe 2 javëve të praktikës në Gjykatën e Lartë etj¹.

Çdo dosje kishte 100 pikë, me koeficient vështirësie 2.15. Vlerësimi maksimal në total ishte 860 pikë. Dosjet e përgatitura nga kandidatët për magjistratë ishin një risi për këtë vit akademik. Dosjet u korrigjuan nga mentorët udhëheqës dhe grupet e pedagogëve për secilën dosje. Ajo që u vu re ishte vlerësimi me pikët maksimale nga ana e mentorëve dhe diferenca e pikëve është bërë nga pedagogët që korrigjuan aktet dhe memot e përgatitura nga kandidatët.

Vlerësimi total i të gjithë komponentëve të vitit të dytë është 2025 pikë dhe del si rezultat i mbledhjes së pikëve të kurseve dhe pjesës praktike.

“Vlerësimi i kandidatëve për magjistratë për çdo kurs”:

Niveli “Shkëlqyeshëm”	është 100 (njëqind) pikë;
Niveli “Shumë mirë”	është 90-99 (nëntëdhjetë deri në nëntëdhjetë e nëntë) pikë;
Niveli “Mirë”	është 70-89 (shtatëdhjetë deri tetëdhjetë e nëntë) pikë;
Niveli “Mjaftueshëm”	është 60-69 (gjashtëdhjetë deri gjashtëdhjetë e nëntë) pikë;
Niveli “Pamjaftueshëm”	është 0-59 (zero deri pesëdhjetë e nëntë) pikë

Provimi përfundimtar i vitit të dytë

Provimi përfundimtar u zhvillua me shkrim në datat 26 dhe 27 qershor 2025 me katër raste praktike nga fushat e mëposhtme:

- a) pjesa e parë - E drejta private (civile) dhe e drejta procedurale civile;
- b) pjesa e dytë - E drejta penale dhe procedurale penale;
- c) pjesa e tretë - E drejta administrative materiale dhe e drejta procedurale administrative;
- ç) pjesa e katërt - E drejta publike (kushtetuese).

Komisioni i korrigjimit të provimit përfundimtar u zgjodh me vendimin nr. 16, datë 13.5.2025, “Për caktimin e anëtarëve të Komisionit të Provimit Përfundimtar të vitit të dytë të vitit akademik 2024-2025” të Këshillit Drejtues.

Provimi përfundimtar u vlerësua nga një komision i përbërë nga gjashtë anëtarë, nga të cilët katër anëtarë nga radhët e pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm të Shkollës së

¹ Më të detajuara përshkrimet për secilën dosje gjenden në planin mësimor të vitit të dytë akademik 2024-2025.

Magjistraturës, përgjegjës të lëndëve kryesore dhe nga një anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë miratuar me vendimin nr.16, datë 13.5.2025 të Këshillit Drejtues, “Për caktimin e anëtarëve të komisionit të provimit përfundimtar të vitit të dytë për vitin akademik 2024-2025”.

Gjatë provimit, e gjithë salla u mbikëqyr nga një komision i ngritur për këtë qëllim nga Drejtoria e Shkollës. Nga Komisioni i Provimit nuk u konstatuan raste të mungesës së tezave në zarfet A4. Provimi iu nënshtrua procesit të sekretimit, me qëllim ruajtjen e objektivitetit.

Shpallja e rezultateve në bazë të numrave të sekretimit u bë më datë 8 korrik 2025. Po në këtë datë, u bë dhe hapja e zarfeve të vegjël me emrat në prani të kandidatëve për magjistratë.

Pas marrjes së rezultateve, kandidatët verifikuan përgjigjet e tyre. Fletët e provimit u panë nga kandidatët, vetëm në sallën e vënë në dispozicion nga Shkolla. Nuk u lejua fotokopjimi ose marrja e fletëve të provimit.


Vlerësimi maksimal i të gjithë komponentëve të vitit të dytë u bë me vendimin nr. 3, datë 21.7.2025, “Vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për magjistratë të vitit të dytë për vitin akademik 2024-2025” të Këshillit Pedagogjik dhe është shumatorja e:

- a) 2250 pikëve të vitit të parë;
- b) 2025 pikëve të vitit të dytë;
- c) 200 pikëve të provimit përfundimtar.

Totali i vlerësimit të dy viteve të para është 4675 pikë.

Rezultatet e arritura nga 62 kandidatët në vitin e dytë ishin të kënaqshme. 33 kandidatë për gjyqtarë janë vlerësuar me “shumë mirë” dhe 4 kandidatë për gjyqtarë me “mirë”.

Ndër kandidatët e profilit prokuror, 14 janë vlerësuar “shumë mirë” dhe 11 janë vlerësuar “mirë”.



1.4 VITI I TRETË AKADEMIK 2024-2025

Viti i tretë akademik 2024-2025 u ndoq nga 42 kandidatë për magjistratë profili gjyqtar dhe 26 kandidatë për magjistratë profili prokuror.

Plani mësimor i vitit të tretë, bazuar në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligjin nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, u miratua me Vendim të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

Bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, praktika profesionale zgjati 12 muaj, duke filluar në muajin korrik 2024 dhe duke përfunduar në muajin qershor 2025.

Kandidatët për magjistratë të vitit të tretë, kryen praktikën profesionale pranë gjykatave dhe prokurorive të shkallës së parë, të udhëhequr nga një trup magjistratësh udhëheqës, të miratuar nga KLGG-ja dhe KLP-ja. Ata realizuan vlerësimin profesional dhe etik të secilit kandidat, bazuar në kriteret dhe nivelet e vlerësimit të përcaktuara në ligj.

Për vitin akademik 2024 – 2025 praktikën profesionale kandidatët për magjistratë e kryen përkatësisht:

Kandidatët për gjyqtarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, të ndarë në Dhomën Civile dhe Penale, Gjykatën Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

Kandidatët për prokurorë, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Vlerësimi në vitin e tretë

Në vitin e tretë:

- Vlerësimi i kandidatëve nuk bëhet më nga pedagogët e shkollës, por nga magjistrati udhëheqës, i cili ndjek nga afër ecurinë e kandidatëve gjatë zhvillimit të praktikës profesionale.
- Ky vlerësim përfshin aspektin etik, profesional dhe cilësor të përgatitjes së tyre.
- Qëllimi i praktikës gjatë vitit të tretë është garantimi i një formimi të plotë dhe të qëndrueshëm profesional, para se kandidati të marrë statusin përfundimtar të magjistratit.

Procesi i vlerësimit bazohet në nenin 71 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”. Ky nen përcakton katër kriter kryesore:

1. **Aftësitë profesionale** – përfshirë njohuritë juridike, aftësinë për të zbatuar ligjin dhe për të arsyetuar në mënyrë logjike e të paanshme.
2. **Aftësitë organizative** – si kandidati menaxhon dosjet, afatet dhe punën e përditshme gjyqësore ose hetimore.
3. **Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale** – respektimi i parimeve të paanshmërisë, ndershmërisë, integritetit dhe korrektësisë në marrëdhënie me palët.

4. **Aftësitë personale dhe angazhimi profesional** – komunikimi, përgjegjshmëria, përkushtimi në detyrë, puna në ekip dhe qëndrueshmëria nën presion.


Vlerësimi për secilin kandidat për magjistrat bëhet nga tre magjistratë udhëheqës, përkatësisht sipas periudhave katër mujore në të cilat realizohet praktika profesionale.

Çdo magjistrat udhëheqës vlerëson me 100 pikë kandidatin për magjistrat, në bazë të kriterëve dhe niveleve të përcaktuara në ligjin, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në total, vlerësimi i bërë nga tre magjistratët udhëheqës është 300 pikë dhe ka koeficient vështirësie 2.

Gjatë vitit të tretë kandidatët për magjistratë u vlerësuan nga udhëheqësit e praktikës, me një mesatare prej 599.32 pikësh për kandidatët për magjistratë profili gjyqtar dhe 600 pikësh për kandidatët për magjistratë, profili prokuror.

Kandidati që u rendit i pari në profilin gjyqtar kishte 5086.6 pikë, ndërsa kandidati që u rendit i pari në profilin prokuror kishte 5015.75 pikë nga 5275 pikë që ka në total realizimi me sukses i tre viteve të Programit të Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës.



Vlerësimi përfundimtar i kandidatëve për magjistratë

Këshilli Pedagogjik, me vendimin nr. 2, datë 27.6.2025, “Për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për magjistratë të vitit të tretë akademik 2024-2025”, miratoi vlerësimin përfundimtar për të tri vitet, në bazë të rezultateve të provimeve të vitit të parë, të rezultateve të vitit të dytë, rezultateve të provimit përfundimtar në fund të vitit të dytë, si dhe pikëve të vitit të tretë të stazhit profesional, sipas sistemit me 5 nivele, mbi bazën e një renditje përfundimtare të tyre me pikë për 68 kandidatë për magjistratë.

Vlerësimi përfundimtar i përgjithshëm është 5275 pikë.

Drejtori i Shkollës i paraqiti një raport Këshillit Drejtues, së bashku me Vendimin e Këshillit Pedagogjik mbi renditjen përfundimtare të kandidatëve për magjistratë të diplomuar.

Këshilli Drejtues, me vendimin nr. 19, datë 14.7.2025, “Për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për magjistratë të vitit të tretë akademik 2024-2025 në Programin e Formimit Fillestar” miratoi renditjen përfundimtare të kandidatëve magjistratë të diplomuar në vitin akademik 2024 – 2025.

Shkolla publikoi listën e kandidatëve magistratë, të diplomuar në Formimin Fillestar për periudhën 2022-2025 në faqen zyrtare www.magjistratura.edu.al, duke bërë publike edhe renditjen përfundimtare të tyre.

Diplomimi

Në datën 30 qershor 2025 u organizua ceremonia e diplomimit të kandidatëve për magistratë të cilët përfunduan programin tre-vjeçar të Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës për brezin 2022 – 2025. Ceremonia u zhvillua në sallën Antigonea të hotel “Rogner”, pjesë e konferencës kombëtare me temë: *“Dimensioni i Integritetit në funksionin e Magjistratit. Angazhimi ndaj Drejtësisë”* organizuar nga Shkolla e Magjistraturës dhe Projekti i Binjakëzimit me Bashkimin Evropian.

Rezultatet e arritura nga 68 kandidatë të cilët përfunduan Programin e Formimit Fillestar 2022-2025 janë:

40 kandidatë për gjyqtarë janë vlerësuar “shumë mirë” dhe 2 kandidatë për gjyqtarë janë vlerësuar “mirë”.

10 kandidatë për prokurorë janë vlerësuar “mirë” dhe 16 kandidatë “shumë mirë”.



1.5 PËRMBUSHJA E OBJEKTIVAVE MËSIMORE

Procesi trajnues në Shkollën e Magjistraturës gjatë vitit akademik 2024–2025 është zhvilluar në përputhje me programin e formimit fillestar për kandidatët për magjistratë dhe ndihmës ligjorë, duke synuar zhvillimin e aftësive praktike dhe forcimin e etikës profesionale dhe intergjitit. Objektivat kryesorë të arritur përfshijnë:

1. Thellimi i njohurive juridike dhe aftësive analitike

Kandidatët kanë përvetësuar njohuri të qëndrueshme teorike e praktike në fushat e së drejtës penale, civile, administrative, kushtetuese etj., si dhe aftësi për interpretimin dhe zbatimin e ligjit në bazë të jurisprudencës vendase dhe europiane (GJEDNJ, GJED). Ata janë aftësuar të identifikojnë çështjet juridike, të analizojnë provat dhe të vlerësojnë ndikimin shoqëror të zbatimit të së drejtës. Kandidatët për ndihmës ligjorë janë aftësuar në mënyrë të vecantë edhe për shkrimin dhe arsyetimin ligjor përmes mundësisë që i dha lënda “Shkrim dhe arsyetim ligjor” për tu përshtatur dhe specializuar për këto subjekte.

2. Aftësimi në hetimin paraprak dhe përgatitjen e çështjes

Kandidatët janë trajnuar për të vlerësuar aspektet procedurale dhe përmbajtjesore të dosjeve, për të përcaktuar provat thelbësore dhe për të ndërtuar strukturën e veprimeve paraprake. Theksi është vënë tek aftësia për bashkëpunim procedural dhe vlerësim të alternativave të zgjidhjes jashtëgjyqësore.

3. Aftësimi në drejtimin e debatit gjyqësor

Kandidatët janë përgatitur për të organizuar dhe drejtuar debatin gjyqësor me profesionalizëm, duke respektuar parimin e paanshmërisë e të drejtave të palëve. Është vlerësuar aftësia për të ndërtuar strategji pyetjesh dhe për të siguruar qartësi në paraqitjen e fakteve dhe argumenteve.

4. Aftësimi në përgatitjen e akteve dhe marrjen e vendimeve

Theksi është vendosur tek aftësia për të hartuar akte procedurale dhe vendime të arsyetuara, të bazuara në analiza të plota faktike dhe juridike. Kandidatët kanë zhvilluar shprehje për komunikim të qartë juridik dhe për debat konstruktiv në dhomë këshillimi apo grup hetimor.

5. Forcimi i integritetit, etikës dhe vetëdijes shoqërore

Në fokus ka qenë zhvillimi i ndershmërisë, paanshmërisë dhe përgjegjshmërisë profesionale. Kandidatët janë ndërgjegjësuar për rolin e tyre shoqëror si magjistratë, për shmangien e konfliktit të interesit dhe për vlerësimin e efektit shoqëror të vendimeve gjyqësore. Gjithashtu, është promovuar aftësia për të reflektuar mbi politikat penale, civile dhe administrative dhe për të kontribuar në përmirësimin e legjislacionit.

6. Bashkëpunimi, transparenca dhe komunikimi profesional

Kandidatët janë trajnuar për të punuar në mënyrë bashkëpunuese, për të dhënë dhe pranuar feedback konstruktiv dhe për të ruajtur transparencën në veprimet profesionale. Janë forcuar aftësitë e komunikimit të qartë, respektimit të diversitetit dhe konfidencialitetit, si dhe etiketa institucionale në marrëdhëniet profesionale.

1.6 STAFI PEDAGOGJIK

Shkolla e Magjistraturës i kushton një rëndësi të veçantë stafit pedagogjik që për zgjedh duke synuar të përmbushë standarde ekselence në mësimdhënie. Kushtet dhe kriteret për të qenë pedagog në Shkollë janë të parashikuara në ligj dhe procedura e për zgjedhjes së tyre është pjesë e rëndësishme e Rregullores së Brendshme të Shkollës.


Në Programin e Formimit Fillestar për vitin akademik 2024-2025 u angazhuan 9 (nëntë) pedagogë të brendshëm dhe 61 pedagogë të jashtëm, 16 pedagogë në dispozicion, 1 asistent pedagog, si dhe 15 specialistë, pjesa më e madhe e të cilëve ishin gjyqtarë dhe prokurorë në sistem.

Në lëndët kryesore përqindja e gjyqtarëve dhe prokurorëve të angazhuar është edhe më e lartë, konkretisht 35 gjyqtarë/prokurorë në 18 pedagogë.


Në vitin e dytë kontribuan 15 pedagogë të jashtëm dhe 4 specialistë të fushës, nga të cilët 50% gjyqtarë/prokurorë. Shkolla gjithashtu, miratoi edhe pedagogë në dispozicion për të ofruar ekspertizë në momentet kur është vlerësuar e nevojshme nga pedagogët e lëndës. Pedagogët në dispozicion kanë qenë dy.

Sa i përket angazhimit të stafit pedagogjik me grada dhe tituj shkencorë, 27.27% e të gjithë stafit pedagogjik është me gradën Doktor/Profesor i asociuar/profesor, nga 110 që është numri total i pedagogëve, specialistëve, asistent pedagogëve, pedagogëve në dispozicion të miratuar me vendimin nr. 36, datë 27.9.2025 të Këshillit Drejtues.

Përbërja e stafit pedagogjik - Programi i Formimit Fillestar 2024-2025



Niveli akademik i stafit pedagogjik - Viti akademik 2024-2025



1.7 KONKURSI I PRANIMIT 2025-2026

Provimi i pranimit për vitin akademik 2024–2025

Pas shpalljes nga Këshilli i Lartë Gjyqësor të 10 vendeve vakante për profilin gjyqtar dhe 3 vendeve vakante për profilin ndihmës ligjor, nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë të 12 vendeve vakante për profilin prokuror dhe 3 vendeve vakante për profilin këshilltar ligjor në prokurori, si dhe, për herë të parë, nga Avokatura e Shtetit të 7 vendeve për avokat shteti në nivel vendor, Këshilli Drejtues i Shkollës mori vendimin nr. 1, datë 30.1.2025, “Për provimin e pranimit për vitin akademik 2025-2026” dhe Shkolla e Magjistraturës nisi procedurat për zhvillimin e provimit të pranimit për vitin akademik 2025–2026.

Njoftimi publik

Më datë 31 janar 2025, Shkolla e Magjistraturës publikoi njoftimin “Thirrje për aplikime për provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës”, duke bërë publik:

- numrin e vendeve vakante;
- kriteret e pranimit;
- afatet për paraqitjen e dokumentacionit;
- programin dhe literaturën përkatëse të provimit.

Vlerësimi paraprak i kandidatëve konkurrues

Me urdhrin e brendshëm nr. 29, datë 3.2.2024, u ngrit Komisioni i Vlerësimit Paraprak, i cili verifikoi dokumentacionin e dorëzuar nga konkurrentët dhe përcolli raportet përkatëse pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Këto institucione dërguan opinionet e tyre përfundimtare mbi vlerësimin e kandidatëve që plotësonin dhe nuk plotësonin kriteret e pranimit, bazuar në nenin 28 të ligjit nr. 96/2016 dhe nenin 10 të Rregullores së Brendshme të Shkollës.

Raporti i vlerësimit përfundimtar

Duke marrë në konsideratë opinionet e institucioneve përkatëse, Shkolla shpalli publikisht në faqen e saj zyrtare raportin përfundimtar të kandidatëve që u lejuan të marrin pjesë në provimin e pranimit për vitin akademik 2025–2026, gjithsej 299 kandidatë.

Trajnimi i konkurrentëve

Më datë 14 prill 2025, Shkolla zhvilloi trajnimin “Mbi rregullat e provimit të pranimit për vitin akademik 2025-2026”, duke u ndalur te:

- Rregullat e përgjithshme të testimit;
- Përdorimin e fletës Scantron për testimin elektronik;
- Metodologjinë dhe menaxhimin e fazës së dytë profesionale të provimit.

Pajisja scan tron

Bazuar në Aneksin 19 të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës, miratuar me vendimin nr. 2, datë 30.1.2025, “Rregullore për përdorimin dhe menaxhimin e pajisjes scan tron për vlerësimin elektronik të fazës së parë të provimit të pranimit në Shkollën e Magjistraturës”, me urdhrin nr. 90, datë 10.4.2025, “Për ngritjen e grupit të punës për kontrollin dhe testimin e

pajisjes scan tron” u ngrit grupi i punës për kontrollin dhe testimin e pajisjes scan tron, e cila do të përdorej në vlerësimin elektronik të fazës së parë të provimit të pranimit për vitin akademik 2025-2026.

Grupi i punës në datën 15.4.2025, mbajti procesverbalin nr. 567 prot., datë 15.4.2025, ku përshkroi hapat që ndoqi për kalibrimin e pajisjes scan tron dhe testit për verifikimin e saktësisë së pajisjes. Rezultatet e testimit konfirmuan funksionimin korrekt të pajisjes pas kalibrimit.

Në datën 18.4.2025, u mbajt procesverbali i testimit të letrës scan tron, me nr. 581, datë 18.4.2025, për testimin/provën e fletëve scantron të cilat do të përdreshin nga konkurrentët në provimin e pranimit 2025-2026 me skanerin scan tron të Akademisë së Sigurisë, i cili do të shërbente si bac up gjatë provimit.

Zhvillimi i provimit të pranimit

Provimi i pranimit u zhvillua në datat:

- **22 prill 2025** – Faza e parë: testimi elektronik;
- **24 dhe 25 prill 2025** – Faza e dytë: testimi profesional.

Programi dhe fondi i pyetjeve

Me urdhrin nr.62, datë 28.2.2025, “Për krijimin e komisionit të rishikimit të tezave të fazës së parë dhe të dytë për lëndët e programit të konkursit të pranimit për vitin akademik 2025-2026” u caktuan komisionet e rishikimit për secilën lëndë.

Anëtarët e komisioneve e rishikuan edhe një herë fondin e pyetjeve dhe kazuseve dhe ndërhyrë aty ku e panë të nevojshme.

Programi i provimit të pranimit nuk pësoi ndryshime. Ky program është i publikuar në faqen zyrtare të Shkollës. <https://www.magjistratura.edu.al/sq/konkursi-i-provimit-te-pranimit>

Komisioni i vlerësimit elektronik

Me vendimin nr. 9, datë 17.4.2025, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës miratoi komisionin e vlerësimit elektronik të fazës së parë të provimit të pranimit për vitin akademik 2025-2026.

Koha e kryerjes së provimit

Provimi u zhvillua vetëm me shkrim dhe ishte i ndarë në dy faza.

Faza e parë u zhvillua në datë 22 prill 2025 dhe zgjati 2 orë e 30 minuta.

Faza e dytë u zhvillua në datat 24 dhe 25 prill 2025. Provimi zgjati 3 orë në secilën ditë.

Faza e Parë e Testimit – Testi i Vlerësimit Elektronik

Faza e parë e provimit të pranimit u zhvillua më datë 22 prill 2025, në mjediset e hollit të Pallatit të Kongreseve. Në provim u paraqitën 282 konkurrentë, nga 299 konkurrentë që kishte kaluar Komisioni i Verifikimit të Dokumentacionit.

Përpara nisjes së shpërndarjes së tezës, Shkolla shpjegoi për konkurrentët rregullat dhe mënyrën e plotësimit të fletës *scantron* për këtë fazë.

Konkurrentët firmosën deklaratën për njohjen dhe pranimin e rregullave të provimit të pranimit në Shkollën e Magjistraturës.

Në fazën e parë të provimit të pranimit, teza e provimit përbëhet nga 10 Rubrika. Çdo rubrikë është e pajisur me fondin e pyetjeve, e ndarë në zarf më vete.

Teza e provimit të kësaj faze u krijua në sallën e provimit, sipas zgjedhjes rastësore të bërë nga konkurrentët.

Një pjesë e shkurtër e pyetjeve u lexua publikisht para kandidatëve për të garantuar që fondi i pyetjeve nuk ishte i përsëritshëm dhe pasi u formua teza me 100 pyetje, u fotokopjua në prani të konkurrentëve në sallën e provimit. Teza ishte e njëjtë për të gjithë.

Kandidatët zgjedhën 10 teza nga rubrikat e testit të përgjithshëm, si më poshtë:

Rubrika I - E drejtë kushtetuese dhe të drejtat e njeriut teza nr. 2

Rubrika II – E drejtë administrative dhe e drejtë pune teza nr. 11

Rubrika III – E drejtë penale dhe procedurë penale teza nr.4

Rubrika IV – Procedurë civile dhe e drejtë civile teza nr.18

Rubrika V – E drejtë familjare dhe e drejtë tregtare; teza nr. 8

Rubrika VI – - E drejtë e BE-së dhe e drejta ndërkombëtare publike teza nr.1

Rubrika VII - Historia e së drejtës në Shqipëri teza nr. 2

Rubrika VIII – Gjuha shqipe teza nr. 14

Rubrika IX – Testi i inteligjencës teza nr.10

Rubrika X – Etikë profesionale teza nr. 6



Në përfundim, kandidatë dorëzuan fletën e plotësuar të scantronit. Përgjigjet u lexuan në mënyrë elektronike nga pajisja Scantron OpScan 4ES, e cila nxori renditjen e rezultateve.

Pas leximit të saktë të 282 fletëve të provimit, u konstatua se 118 konkurrentë kishin kaluar pragun 60% të pikëve.

Pas verifikimeve dhe shqyrtimit të 58 kërkesave për të parë fletën e scan tronit dhe çelësin e përgjigjeve (përfshirë edhe ato të ardhura me e-mail), rezultoi se 118 konkurrentë përmbushnin kriterin minimal për kualifikim në fazën e dytë të testimit.

Në përfundim të procesit, Komisioni i Vlerësimit Elektronik certifikoi 118 konkurrentë si të kualifikuar për në fazën e dytë të provimit të pranimit për vitin akademik 2025–2026 të Shkollës së Magjistraturës.

Faza e dytë – Testi profesional

Zhvillimi i fazës së dytë të provimit

Në ditën e parë të provimit, datë 24 prill 2025, u paraqitën 118 konkurrentë.

Në ditën e dytë të provimit të pranimit, datë 25 prill 2025, u paraqitën 118 konkurrentë.

Formimi i tezës

Në dy ditët e provimit, teza e provimit të kësaj faze u krijua në sallën e provimit, sipas zgjedhjes rastësore të bërë nga konkurrentët. Pyetjet u lexuan publikisht para kandidatëve. Tezat u fotokopjuan në sallë në prani të konkurrentëve.

Në ditën e parë, datë 24 prill 2025, kandidatët zgjedhën 5 teza, nga pesë rubrikat e testit profesional, si më poshtë:

- E drejta civile – teza 16
- E drejta penale – teza 8
- E drejta procedurale civile – teza 3
- E drejta procedurale penale – teza 24
- E drejtë familjare – teza 6



Në ditën e dytë, datë 25 prill 2025, kandidatët zgjedhën 3 raste praktike, nga 3 zarfet me raste praktike në tre fushat e vlerësimit, sipas rregullores, si më poshtë:

- Kazusi E drejtë Civile – Kazusi nr. 2
- Kazusi Drejtë Penale – Kazusi nr. 7
- Kazus Administrativ – Kazusi nr. 4

Në fazën e dytë morën pjesë 118 konkurrentë. Procesi u monitorua nga përfaqësues ndërkombëtarë dhe u zhvillua në mënyrë transparente.

Vlerësimi dhe pikëzimi

Testi profesional u vlerësua maksimalisht me 400 pikë, të ndara si më poshtë:

Pjesa e testit	Përmbajtja	Pikë maksimale
Njohuritë dhe aftësitë teorike	Lëndët kryesore të së drejtës (civile, penale, procedurale dhe degët e tjera)	250
Raste praktike	3 raste nga fusha të ndryshme të së drejtës	150
Totali		400

Monitorimi

Monitorimi i kandidatëve gjatë provimit në të dy ditët u realizua nga një ekip i përbërë nga monitorues të huaj dhe vendas, jo juristë, të parashikuar në urdhrin me nr. 89, datë 10.4.2025, “Për procesin e zhvillimit të provimit të pranimit për vitin akademik 2025-2026”. Monitoruesit e jashtëm ishin nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, OSBE, Këshilli i Europës dhe EU4Justice.

Procesi i provimit nuk pati asnjë kontestim nga konkurrentët apo monitoruesit. Pas përfundimit të provimit fondi i tezave u depozitua në kasafortën e Shkollës.

Anonimizimi i tezave me përgjigjet

Në përfundim të zhvillimit të provimit, në ditën e parë, 5 tezat me përgjigjet e konkurrentëve u vendosën në zarf A4, i cili u mbyll dhe u vulos në prani të konkurrentëve. Njëherësh, konkurrentët shkruan emrin e tyre në zarfin e vogël. Edhe ky zarf u pa, u mbyll dhe u vulos në prani të konkurrentit. Dy zarfet u kapën me kapëse së bashku, në mënyrë që më pas të vijonte procesi i vendosjes së numrave të sekretimit.

E njëjta procedurë u zhvillua edhe ditën e dytë të provimit të fazës së dytë.

Sekretimi dhe kodimi i zarfeve

Përzierja dhe sekretimi i zarfeve u bë në prani të kandidatëve në të dy ditët, 24 dhe 25 prill. Pas përzierjes, personat e ngarkuar sipas urdhrin të Drejtorit për zhvillimin e provimit, kryen procesin e vendosjes së një kodi (numër) për çdo zarf. Ditën e parë, për numrat e sekretimit u përdor ngjyra blu, ndërsa ditën e dytë u përdor ngjyra e kuqe.

Zarfet e mëdhenj dhe zarfet e vegjël u vendosën në kuti të ndryshme. Këto kuti u mbyllën, dhe mbi kutitë e zarfeve të vegjël (ku ishin emrat e konkurrentëve) u vendosën vulat dhe nënshkrimet e disa konkurrentëve të pranishëm në sallë. Konkurrentët u vendosën në dijeni për rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre ditën që do të bëhej procesi i shpalljes në Shkollë.

Ruajtja dhe mbajtja e kutive

Kutitë e provimit u vendosën në kasaforta të posaçme. Për hapjen e tyre me qëllim korrigjimi kërkohej njëherësh kodi dhe çelësi. Të dyja këto elemente sigurie janë mbajtur nga persona të ndryshëm.

Korrigjimi dhe vlerësimi i tezave

Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, me vendimin nr. 12, datë 25.4.2025, miratoi anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Testit Profesional, gjithsej 7 anëtarë të propozuar nga Drejtori i Shkollës nga radhët e pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm të Shkollës me përvojë mësimdhënieje mbi 5 vjet, sipas Rregullores.

Në datën 28 prill 2025 Komisioni i Vlerësimit të Provimit u mbledh në Shkollë për të hartuar çelësin e përgjigjeve për secilën tezë. Çelësi i përgjigjeve u hartua atë ditë, iu dorëzua i nënshkruar administratorit të provimit dhe u publikua menjëherë në faqen e Shkollës.

Komisioni filloi nga puna në datën 29 maj dhe procesi i korrigjimit vazhdoi deri në datën 5 maj 2025 (7 ditë). Orari i korrigjimit niste pa ndërprerje në orën 8.30 deri në orën 18.00 të çdo dite.

Korrigjimi i tezave nga Komisioni i Vlerësimit u zhvillua në një sallë të veçantë në Shkollën e Magjistraturës, në prani të personave të miratuar me urdhrin e drejtorit nr. 89, datë 10.4.2025 dhe nr. 93 prot., datë 28.4.2025. Në përfundim të çdo dite vlerësimesh, kutia me fletët e provimeve transferohej nga pesë nëpunës të Shkollës së Magjistraturës në kasafortë.

Dalja e rezultatit

Me mbarimin e vlerësimit, u bë mbledhja e të gjitha pikëve sipas dy ditëve të provimit. 70 (shtatëdhjetë) numrat e parë të sekretimit, të cilët rezultonin me pikët më të larta, kaluan në një vlerësim të kryqëzuar nga anëtarët e komisionit. Në fund të këtij procesi, Shkolla bëri publike për kandidatët rezultatet e korrigjimit me pikët për çdo numër sekretimi.

Shpallja e rezultateve

Shkolla e Magjistraturës, në datën 5 maj 2025 njoftoi publikisht për zhvillimin e procesit të identifikimit më 6 maj 2025, ora 9.30. Më 5 maj në mjediset e Shkollës dhe në faqen zyrtare dolën paraprakisht rezultatet e provimit të fazës së dytë, sipas numrave të sekretimit për të dyja ditët.



Procesi i identifikimit filloi në orën 9:30 minuta. Në shpalljen e rezultateve ishin të pranishëm pjesa më e madhe e konkurrentëve. Ky proces u ndoq në kohë reale nga të interesuarit, në adresën e njoftuar nga Shkolla, në mënyrë që kushdo të njihej me procedurën dhe rezultatet e vlerësimit. Në përfundim të këtij procesi, Shkolla publikoi

listën përfundimtare ku u renditën konkurrentët sipas pikëve të marra prej tyre në fazën e dytë të provimit të pranimit.

Mbi rezultatet e vlerësimit

Nga 118 (njëqind e tetëmbëdhjetë) konkurrentë që morën pjesë në fazën e dytë të provimit të pranimit, 20 (njëzet) prej tyre arritën të vlerësohen me më shumë se 60% (gjashtëdhjetë për qind) të pikëve maksimale të mundshme për të dy ditët (katërqind pikë). Pra, 17% (shtatëmbëdhjetë për qind) e konkurrentëve arritën të kalonin pragun minimal të vendosur nga Rregullorja. Trembëdhjetë konkurrentët e renditur menjëherë pas tyre e deri në konkurrentin e fundit që kishte mbi 200 (dyqind) pikë në këtë provim (50% (pesëdhjetë për qind) e pikëve totale të fazës së dytë), varësisht nga interesi i tyre, vijuan të konkurrojnë për pozicionet e këshilltarit ligjor në Prokurori, Avokatit të Shtetit në nivel vendor dhe ndihmësit ligjor.

Testimi i tretë- testi i shëndetit mendor dhe psikologjik

Në zbatim të ligjit nr. 115/2016 dhe Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, pas testimit profesional, kandidatët e kualifikuar me pikët më të larta në rend zbritës (deri në 60% të pikëve të marra nga ky testim për kandidatët për gjyqtarë/prokurorë dhe 50% të pikëve për kandidatët për ndihmës ligjorë, këshilltarë ligjor dhe avokat shteti në nivel vendor) deri në limitin e vendeve të shpallura vakante, kaluan në testimin e shëndetit mendor dhe psikologjik.

Shkolla hartoi listën e konkurrentëve fitues, sipas profileve që ata kishin zgjedhur, për t'i thirrur në testimin e shëndetit mendor dhe psikologjik.

Dy nga fituesit e renditur për profilin e prokurorit, nuk rezultuan fitues për shkak të zgjedhjes së tyre vetëm për gjyqtar. Gjithashtu, ata shprehën edhe vullnetin e tyre se nuk ishin të interesuar për këtë profil, edhe nëse do të kishte ndonjë mundësi për t'u renditur fitues.

Testimi i shëndetit mendor dhe psikologjik u realizua me shkrim, në datë 8 maj 2025 dhe me gojë në datat 9 dhe 10 maj 2025.

Komision i miratuar nga Këshilli Drejtues i Shkollës me vendimin nr.12, datë 25.4.2025 kishte në përbërje dy psikologë dhe dy psikiatër, si dhe një pedagog të brendshëm në rolin e vëzhguesit. Rezultatet e testimit iu bënë me dije Administratorit të Provimit dhe Këshillit Drejtues të Shkollës. Komisioni vlerësoi se të gjithë konkurrentët që morën pjesë në këtë testim ishin të përshtatshëm.


TË DHËNA STATISTIKORE

Eksperienca e mëparshme në punë

Ky tregues është me interes për t'u paraqitur për shkak të një lidhje që mund të bëhet mes viteve në punë dhe mundësisë për të qenë fitues në provimin e pranimit. Kjo lidhje nuk është shkencore, por krijon një premisë për të diskutuar, për shkak se, për të qenë më objektive do të kërkonte edhe raportin mes konkurrentëve.


Nisur nga të dhënat statistikore të kandidatëve që u shpallën fitues, për vitin akademik 2025-2026, rezulton se pjesa më e madhe e tyre (kandidatë) kanë një eksperiencë të paktën 4-5

vjeçare. Në vend të dytë vijnë kandidatët me mbi 3 vite, në vend të tretë janë kandidatët që kanë mbi 7-12 vjet eksperiencë. Më poshtë, paraqitja grafike:



Fakulteti ku kanë zhvilluar studimet për drejtësi

Sipas të dhënave të kandidatëve, rezulton se në vitin akademik 2025-2026, 29 kandidatët e vitit të parë i kanë kryer studimet për drejtësi në fakultetet shqiptare, nga të cilët 26 kandidatë kanë kryer studimet në fakultetet publike dhe një në fakultetet e drejtësisë private. Vetëm një kandidat është diplomuar në fakultetet e drejtësisë jashtë shtetit.



1.8 AKTIVITETE TË NDRYSHME TË PROGRAMIT TË FORMIMIT FILLESTAR

1.8.1 Bashkëpunimi midis Shkollës së Magjistraturës dhe projektit të binjakëzimit

Bashkëpunimi midis SHM-së dhe projektit të binjakëzimit ka synuar përmirësime të rëndësishme në Programin e Formimit Fillestar. Projekti në të gjitha hapat e realizuar ka mbështetur:

1. Reformimin e kurikulës së vitit të parë

- Kurikula synohet të riorganizojë lëndët e vitit të parë përmes një procesi analize të hollësishëm përmbajtësor të saj;
- Synohet të përmirësohet metodologjia që do të zbatohet për zhvillimin e kurikulës, përmes metodave interaktive të trajnimit dhe materialeve studimore të cilat do të jenë bazuar në dosje praktike gjyqësore dhe akte të tjera nga praktika.

2. Përgatitjen e stafit pedagogjik



- Mentorët dhe trajnerët u trajnuan përgjatë gjithë procesit analizues dhe zhvillues të metodologjisë së re.
- U forcua skema e mentorimit për vitin e dytë dhe të tretë.

3. Hartimin e moduleve të reja të bazuara në kompetenca

- Aftësitë dhe kompetencat që synohen të arrihen nga kandidatët duhen parë si pjesë integrale dhe e vazhdueshme e formimit të tij përgjatë tre viteve. Nivelet e kompetencave duhet të përshkallëzohen dhe vendosen indikatorë të qartë për matjen e progresit.

4. Përmirësimin e metodave të vlerësimit

- U propozuan forma të reja vlerësimi, që masin jo vetëm aftësitë argumentuese dhe analitike të kandidatëve, por dhe aftësitë jo-ligjore “soft skills”.
- U propozua që vlerësimi të ketë një karakter progresiv.

5. Modernizimin digjital të procesit mësimor

- U mbështet integrimi i platformave digjitale dhe përdorimi i mjeteve teknologjike nga kandidatët.

1.8.2 Zgjedhja e anëtarit të Këshillit Drejtues nga radhët e kandidatëve për magjistratë

Në zbatim të nenit 35 të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, më datë 11 dhjetor 2024 u thirr Asambleja e Kandidatëve për Magjistratë, me rend dite “Zgjedhjen e anëtarit të Këshillit Drejtues nga radhët e kandidatëve për magjistratë”. Procesi i votimit u zhvillua më datë 7 janar 2025, me pjesëmarrjen e 110 kandidatëve për magjistratë.



Pas zhvillimit të votimit të fshehtë, u shpall fitues kandidati që përfitoi numrin më të lartë të votave.

1.8.3 Pjesëmarrja në Konkursin Ndërkombëtar e-THEMIS 2025

Në kuadër të bashkëpunimit me Rrjetin Gjyqësor Evropian të Trajnimeve, Shkolla e Magjistraturës mori pjesë në gjysmëfinalen B të konkursit ndërkombëtar e-THEMIS 2025, që u zhvillua në qytetin e Napolit, Itali, gjatë datave **30 qershor – 4 korrik 2025**.

Skuadra e Shkollës përfaqësoi Shqipërinë me temën **“Kufij ndarës – Sfida juridiksionale në çështjet e divorcit të shtetasve shqiptarë që jetojnë në BE”**, e cila u vlerësua maksimalisht nga juria për qasjen origjinale, analizën krahasuese midis legjislacionit shqiptar dhe atij të BE-së, si dhe përdorimin e shkëlqyer të anglishtes ligjore.



1.9 MARRËDHËNIET E BASHKËPUNIMIT ME KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR (KLGJ) DHE KËSHILLIN E LARTË TË PROKURORISË (KLP)


Shkolla e Magjistraturës ka zhvilluar marrëdhënie të qëndrueshme bashkëpunimi, shkëmbimi informacioni dhe mbështetje reciproke me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Ky bashkëpunim ka synuar forcimin e koherencës ndërinstitucionale dhe përmirësimin e funksionimit të sistemit të drejtësisë, në zbatimin e Programit të Formimit Fillestar dhe vazhdues.

Këshillat kanë bashkëpunuar ngushtësisht me Shkollën edhe në kuadër të Projektit të Binjakëzimit me pjesëmarrje aktive në mbledhjet e Bordit Drejtues të Projektit të Binjakëzimit.

Gjatë periudhës raportuese, bashkëpunimi është konkretizuar në disa drejtime kryesore:

- **Konsultimi për kuotat e pranimit:** Shkolla e Magjistraturës është konsultuar me KLGJ-në dhe KLP-në në lidhje me përcaktimin e kuotave për provimin e pranimit të kandidatëve për magjistratë.
- **Shkëmbimi i informacionit për konkurrentët:** Shkolla ka përcjellë dosjet dhe të dhënat e konkurrentëve dhe ka reflektuar opinionet e Këshillave lidhur me listën përfundimtare të kandidatëve që vijojnë procesin mësimor.
- **Verifikimi i përshtatshmërisë së figurës dhe pasurisë:** Shkolla ka pritur konfirmimet nga Këshillat përpara dhënies së statusit të kandidatit për magjistrat/këshilltar/ndihmës ligjor. Edhe pse konfirmimet nuk janë dërguar brenda afateve ligjore, Shkolla ka lejuar ndjekjen e programit nga kandidatët fitues.
- **Shkëmbimi i vlerësimeve dhe rezultateve:** Shkolla ka përcjellë vendimet e Këshillit Pedagogjik mbi vlerësimet për kandidatët e Programit të Formimit Fillestar dhe rezultatet përfundimtare të subjekteve të rivlerësimit.
- **Bashkëpunimi për zhvillimin e praktikës profesionale:** Këshillat kanë bashkëpunuar ngushtësisht me Shkollën për organizimin e praktikës profesionale, përfshirë:
 - miratimin e gjykatave dhe prokurorive ku kandidatët do të kryejnë praktikën;
 - caktimin e magjistratëve udhëheqës për një periudhë trevjeçare;
 - angazhimin e tyre në veprimtaritë trajnuese të Shkollës;
 - ndarjen e kandidatëve nëpër institucione për vitin akademik 2024–2025.
 - vlerësimin etik dhe profesional të kandidatëve përmes formularëve përkatës, sipas kriterëve ligjore të vlerësimit.
- **Aktivitete për ndërgjegjësimin e magjistratëve udhëheqës:** Shkolla ka organizuar sesione trajnuese me qëllim ndërgjegjësimin e magjistratëve udhëheqës për rëndësinë e procesit të vlerësimit, mënyrën e administrimit të tij, si dhe plotësimin korrekt të formularëve të vlerësimit.

BASHKËPUNIMI MIDIS SHM-SË, KLGJ-SË DHE KLP-SË



Kreu 2

Formimi Vazhdues 2024-2025

2.1 OBJEKTIVAT E PROGRAMIT TË FORMIMIT VAZHDUES NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS

Objektivat kryesorë të Programit të Formimit Vazhdues në Shkollën e Magjistraturës:

1. **Përmirësimi i cilësisë së drejtësisë**
– Përmes trajnimeve të specializuara që adresojnë nevojat konkrete të sistemit.
2. **Transmetimi i njohurive të thelluara juridike**
– Përfshirë analizën e situatave konkrete dhe çështjeve të vështira në praktikën gjyqësore.
3. **Unifikimi i qëndrimeve në çështje të rëndësishme të praktikës gjyqësore**
– Identifikimi dhe zgjidhja e kontradiktave ndërmjet ligjit dhe praktikës, me qëllim harmonizimin e qëndrimeve.
4. **Forcimi i kapaciteteve të sistemit të drejtësisë në tërësi**
– Jo vetëm i gjyqtarëve dhe prokurorëve, por edhe i administratës gjyqësore, kancelarëve dhe nëpunësve të tjerë.
5. **Zhvillimi i aftësive profesionale dhe ndërpersonale**
– Përfshirë komunikimin, etikën profesionale, sjelljen institucionale dhe menaxhimin e kohës.
6. **Rritja e profesionalizmit të pjesëmarrësve**
– Duke u fokusuar në situata praktike dhe duke nxitur angazhimin aktiv të magjistratëve.
7. **Përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstitutional**
– Përmes konsultimit me organet drejtuese të Shkollës dhe institucionet e sistemit të drejtësisë (KLGJ, KLP, MD, ILD, etj.), si dhe partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë.
8. **Sigurimi i një programi gjithëpërfshirës dhe fleksibël**
– I aftë të përshtatet me sfidat e ngarkesës së magjistratëve dhe kufizimeve kohore.
9. **Nxjtja e pjesëmarrjes aktive të magjistratëve në planifikimin e trajnimeve**
– Përmes sugjerimeve për tema dhe kontributit me ekspertizë.



2.2 Dinamika e pjesëmarrjes në trajnime (2024–2025)

Edhe gjatë vitit akademik 2024–2025, programi i Formimit Vazhdues është përballur me disa sfida që lidhen kryesisht me mbingarkesën e gjyqtarëve dhe prokurorëve me dosje, si dhe me vështirësitë për të shkëputur kohë nga detyrimet gjyqësore për pjesëmarrje në trajnime. Kjo situatë, e ndikuar nga fluksi i lartë i çështjeve dhe nga nevoja për përmbushjen e afateve procedurale, ka kërkuar një fleksibilitet të shtuar në planifikimin dhe organizimin e veprimtarive trajnuese.

Megjithatë, pavarësisht vështirësive, interesi i magjistratëve për pjesëmarrje në formimin vazhdues ka mbetur i lartë. Kjo vërtetohet nga numri i konsiderueshëm i aplikimeve për vitin akademik 2024-2025, si dhe angazhimi i tyre aktiv në procesin e planifikimit të trajnimeve, si përmes sugjerimeve për tema të reja, ashtu edhe përmes gatishmërisë për të kontribuar me ekspertizë, çka dëshmon ndërgjegjësimin e tyre për rëndësinë e zhvillimit profesional të vazhdueshëm.

Gjatë vitit akademik 2024 – 2025, Shkolla e Magjistraturës ka trajnuar:

- 259 gjyqtarë,
- 229 prokurorë,
- 134 oficerë të policisë gjyqësore
- 18 kancelarë,
- 25 ndihmës ligjorë,
- 16 këshilltarë ligjorë
- 26 avokatë shteti
- 23 inspektorë dhe ndihmës inspektorë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
- 8 hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit
- 5 koordinatorë të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion
- 68 kandidatë për magjistratë

Në total, 811 subjekte kanë marrë pjesë të paktën një herë në veprimtaritë trajnuese të Shkollës së Magjistraturës, duke treguar përfshirje të gjerë dhe interes të vazhdueshëm për zhvillim profesional në të gjitha hallkat e sistemit të drejtësisë.

2.3 Analiza e nevojave për trajnim dhe miratimi i kalendarit të aktiviteteve trajnuese

Gjatë periudhës 5–19 janar 2024, Shkolla e Magjistraturës zhvilloi 14 takime me gjykatat dhe prokuroritë në rrethe të ndryshme të vendit, me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit me magjistratët dhe identifikimin e nevojave për trajnim të gjyqtarëve, prokurorëve, këshilltarëve ligjorë dhe nëpunësve të tjerë gjyqësorë civilë.

Në këto takime morën pjesë 251 magjistratë dhe përfaqësues institucionalë, përfshirë gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë të shtetit.

Diskutimet u fokusuan në përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetit të programeve të formimit vazhdues, ku u theksuan disa çështje kryesore, ndër to:

- Rëndësia e mentorimit dhe e mbështetjes më të strukturuar për kandidatët e vitit të tretë;
- Nevoja për fleksibilitet në formatet e trajnimit, përfshirë zhvillimin e trajnimeve rajonale dhe online;
- Përzgjedhja e kujdesshme e ekspertëve/lehtësuesve, me fokus në eksperiencën praktike dhe orientimin drejt zgjidhjeve konkrete;
- Përmirësimi i procesit të njoftimeve për pjesëmarrje, me dërgimin e ftesave në kohë të mjaftueshme;
- Krijimi i mekanizmave për vlerësimin e efektivitetit të trajnimeve;
- Zhvillimi i tematikave më të orientuara drejt praktikës gjyqësore dhe problematikave aktuale në sistemin e drejtësisë;
- Rritja e qasjes në materialet e trajnimeve dhe botimeve shkencore përmes platformës online të Shkollës.

Sugjerimet e mbledhura nga këto takime u përdorën si bazë për hartimin e Programit Tematik Trevjeçar 2024–2027, i cili përfshin module të strukturuar sipas fushave të së drejtës dhe synon rritjen e cilësisë, koherencës dhe vazhdimësisë në formimin profesional të magistratëve.

Në përgatitjen e Programit dhe të Kalendarit të aktiviteteve trajnuese për vitin akademik 2024–2025, si edhe çdo vit tjetër, u ndoq gjithashtu një metodologji bashkëkohore dhe gjithëpërfshirëse, e cila ndërthurte burime të ndryshme informacioni dhe instrumente analitike. Hapat kryesorë të procesit përfshinin:

- Mbledhjen dhe analizimin e pyetësorëve të pjesëmarrësve dhe të raporteve të ekspertëve/lehtësuesve pas çdo aktiviteti trajnues;
- Evidentimin e interesit të shfaqur gjatë diskutimeve dhe aktiviteteve interaktive (si sesione brainstorming ose debate tematike);
- Konsultimin me institucionet e sistemit të drejtësisë dhe partnerët kombëtarë e ndërkombëtarë të Shkollës;
- Harmonizimin me legjislacionin e ri që ndikon në veprimtarinë e drejtësisë dhe në procesin e përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian, si dhe me reformat institucionale dhe angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë;
- Analizën e zhvillimeve të fundit në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, për të siguruar përditësimin e përmbajtjes së moduleve trajnuese.

Në përcaktimin e numrit të aktiviteteve trajnuese u mbajt në konsideratë edhe e drejta/detyrimi i magistratëve për të marrë pjesë në të paktën pesë ditë të plota në vit (ligji nr. 96/2016, neni 5, pika 3).

Këshilli Drejtues, me vendimin nr. 18, datë 16.5.2024, miratoi Programin Tematik trevjeçar 2024–2027, dhe me vendimin nr. 20, datë 30.5.2024, miratoi kalendarin e aktiviteteve trajnuese

për vitin akademik 2024–2025, të cilat u publikuan menjëherë në faqen zyrtare të Shkollës së Magjistraturës.

Programi Tematik 3-vjeçar, i miratuar për periudhën 2024–2027, ka sjellë një qasje të re dhe të strukturuar në Formimin Vazhdues, duke organizuar aktivitetet në module të specializuara që përfshijnë fushat kryesore të drejtësisë dhe nevojat praktike të gjyqtarëve, prokurorëve, këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë. Ky program ka mundur harmonizimin e tematikave me zhvillimet ligjore dhe jurisprudencën ndërkombëtare

Kalendari dhe programi tematik iu përcollën Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë si dhe kryetarëve të gjykatave dhe drejtuesve të prokurorive të rretheve dhe të apelit, Avokaturës së Shtetit, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si dhe elektronikisht të gjithë magjistratëve në detyrë.

Në vijim, kryetarët e gjykatave dhe drejtuesit e prokurorive dërguan listat e pjesëmarrësve mbi bazën e formularëve të aplikimit për secilën temë trajnimi.

Më pas, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë miratuan pjesëmarrjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve në programin e Formimit Vazhdues, sipas këtij kalendari.

2.4 Metodologjia

Aktivitetet trajnuese të vitit akademik 2024–2025 u zhvilluan kryesisht në auditorët e Shkollës së Magjistraturës dhe, në disa raste, në formate rajonale dhe online, duke ndjekur metodologjinë që favorizon interaktivitetin dhe diskutimin mes ekspertëve, lehtësuesve dhe pjesëmarrësve.

Trajnimet kombinuan prezantimet me diskutimin e çështjeve të praktikës, ushtrime me raste dhe quiz-e interaktive, duke u fokusuar në zgjidhje praktike dhe krahasimin me standardet ndërkombëtare.

Ekspertët dhe lehtësuesit u udhëzuan që ndërhyrjet gjatë sesioneve të jenë konstruktive, të shpërndara dhe jo dominuese, duke i lënë hapësirë pjesëmarrësve për të diskutuar çështjet e ngritura. Diskutimet bazoheshin tek vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, jurisprudenca ndërkombëtare dhe analizat krahasuese me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe të shteteve të tjera. Çdo panel koordinonte paraprakisht çështjet që do të trajtonte secili ekspert për të siguruar një trajnim të qartë dhe të strukturuar.

2.5 PROJEKTI I BINJAKËZIMIT “FORCIMI I EFIKASITETIT, INTEGRITETIT DHE PROFESIONALIZMIT TË SISTEMIT TË DREJTËSISË DUKE PËRMIRËSUAR KAPACITETET E SHKOLLËS SHQIPTARE TË MAGJISTRATURËS”

Risitë:

Gjatë vitit raportues, në bashkëpunim me projektin e Binjakëzimit “*Forcimi i efikasitetit, integritetit dhe profesionalizmit të sistemit të drejtësisë duke përmirësuar kapacitetet e Shkollës Shqiptare të Magjistraturës*”, u realizuan disa përmirësime me ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe modernizimin e programit të formimit vazhdues.

Së pari, nisi analiza e vlerësimit të ndryshimeve të mundshme metodologjike në funksion të përmirësimit të metodologjisë së hartimit dhe ofrimit të programit të trajnimit vazhdues. Në këtë kuadër, u zhvillua një trajnim trajnerësh në bashkëpunim me shkollën italiane. Ky trajnim kontribuoi edhe në rritjen e kompetencës, eficiencës dhe motivimit të trupës së trajnerëve të Shkollës

Së dyti, Shkolla e Magjistraturës ka nisur të forcojë kapacitetet e saj në drejtim të digjitalizimit të programeve të formimit vazhdues. Në kuadër të projektit, me ndihmën e teknologjisë, u përgatit një program i dedikuar trajnimit mbi zbatimin e jurisprudencës së GjEDNJ-së, me fokus të veçantë të çështjet e pronës, si dhe u zhvillua një modul online për magjistratët. Ky modul bazohet në rezultatet e vlerësimit të nevojave dhe shoqërohet me ndërtimin e kapaciteteve për aplikimin e modeleve bashkëkohore të të mësuarit online.

Këto rezultate përbëjnë kontribut të rëndësishëm në modernizimin e vazhdueshëm të programeve të trajnimit, rritjen e cilësisë së formimit të magjistratëve dhe forcimin e kapaciteteve institucionale të Shkollës së Magjistraturës.

2.6 RITJA E EFICIENCËS SË TRAJNIMIT VAZHDE, FORCIMI I BASHKËPUNIMIT ME GJYKATAT DHE PROKURORITË, SI DHE FORCIMI I ROLIT DHE KONTRIBUTIT TË MAGJISTRATIT”

Gjatë vitit akademik 2024–2025, Shkolla e Magjistraturës ka fokusuar aktivitetet e Programit të Formimit Vazhdues në:

1. Rritjen e eficiencës së trajnimit:

- Përmirësimi i metodologjive trajnuese, duke kombinuar prezantimet me diskutime, kazuse praktike, quiz-e interaktive dhe raste të bazuara në jurisprudencën kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Përdorimi fillestar i Sistemit të Menaxhimit të Veprimtarisë së SHM-së (SMVSHM) për të ndihmuar në organizimin e trajnimeve, monitorimin e pjesëmarrjes dhe shpërndarjen e materialeve.

2. Forcimin e bashkëpunimit me gjykatat dhe prokuroritë:

- Organizimi i takimeve dhe diskutimeve të drejtpërdrejta me gjykatat dhe prokuroritë për përcaktimin e nevojave trajnuese.

- Përfshirja aktive e kryetarëve të gjykatave dhe drejtuesve të prokurorive në hartimin e listave të pjesëmarrësve dhe sugjerimin e tematikave.

3. **Forcimin e rolit dhe kontributit të magjistratit:**

- Magjistratët përfshihen jo vetëm si pjesëmarrës, por edhe si kontribues me sugjerime për temat e trajnimeve, ndihmën në përgatitjen e materialeve dhe eksperiencën praktike gjatë sesioneve.
- Rritja e ndërveprimit dhe pjesëmarrjes aktive të magjistratëve në diskutime dhe zgjidhjen e çështjeve praktike gjatë trajnimeve.

Kjo qasje ka ndihmuar në përmirësimin e cilësisë së trajnimeve, rritjen e efikasitetit të formimit profesional dhe forcimin e rolit të magjistratit si pjesë aktive në procesin e zhvillimit profesional të sistemit të drejtësisë.

2.7 REALIZIMI I KALENDARIT TË TRAJNIMEVE

Trajnimet e planifikuara për vitin akademik 2024–2025, gjatë periudhës tetor 2024 – korrik 2025, ishin fillimisht 153, por ky numër u rrit në 180 aktivitete trajnuese, si pasojë e kërkesave për bashkëpunim nga partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, si dhe pas vlerësimit për zhvillimin e trajnimeve të reja gjatë këtij viti akademik.

Pjesa më e madhe e trajnimeve u zhvilluan në mjediset e Shkollës së Magjistraturës, ndërkohë që një pjesë e tyre, ishin edhe trajnime rajonale të cilat u zhvilluan në qytete të ndryshme të RSH-së.

Disa nga trajnimet rajonale të zhvilluara janë si më poshtë:

Në kuadër të projektit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës PRO-FREX, në partneritet me Shkollën e Magjistraturës në Shqipëri, u zhvillua trajnimi i trajnerëve me temë: *“Përmirësimi i standardeve evropiane për paditë SLAPP dhe liria e shprehjes në Shqipëri”*, në qytetin e Pogradecit, në datat 5-6 dhjetor 2024.

Duke trajnuar trajnerë vendas nëpërmjet kësaj nisme, Këshilli i Evropës dhe Shkolla e Magjistraturës synojnë të krijojnë një sistem të qëndrueshëm trajnimi kaskadë. Kjo qasje siguron që njohuritë dhe mjetet e fituara gjatë seminarit të arrijnë audiencë më të gjerë ligjore dhe gjyqësore, duke forcuar përfundimisht përpjekjet e Shqipërisë për të mbrojtur fjalën e lirë dhe për të luftuar SLAPP-të në përputhje me standardet evropiane të të drejtave të njeriut.



Foto. 1. ToT, “Përmirësimi i standardeve evropiane për paditë SLAPP dhe liria e shprehjes në Shqipëri”

Në kuadër të Projektit të Binjakëzimit, “*Forcimi i efikasitetit, integritetit dhe profesionalizmit të sistemit të drejtësisë duke përmirësuar kapacitetet e Shkollës Shqiptare të Magjistraturës*”, më datat 24–26 qershor 2025 u zhvillua në qytetin e Pogradecit trajnimi i trajnerëve me temë “Rishikimi i Programit të Formimit Fillestar”. Ky aktivitet kishte për qëllim forcimin e kapaciteteve pedagogjike të trajnerëve të Shkollës së Magjistraturës dhe harmonizimin e metodologjisë së formimit me standardet dhe praktikën më të mira evropiane. Gjatë trajnimit u diskutua mbi përmirësimin e strukturës së programit, përditësimin e moduleve dhe përshtatjen e përmbajtjes mësimore me nevojat aktuale të sistemit të drejtësisë dhe procesin e integritetit evropian.




Foto 2. ToT “Rishikimi i Programit të Formimit Fillestar”

Trajnime në bashkëpunim me donatorë:

Partnerët ndërkombëtarë mbështetën disa prej aktiviteteve trajnuese të Shkollës. Numri më i madh i trajnimeve është realizuar nga vetë Shkolla e Magjistraturës edhe pse kërkesat për mbështetje nga partnerët ndërkombëtarë kanë qenë të shumta. Shkolla është kujdesur në mënyrë aktive që mbështetja e partnerëve ndërkombëtarë të bazohet në nevojat reale të SHM-së dhe projektet të mos mbivendoseshin me njëri-tjetrin. Për këtë arsye, kjo mbështetje ka konsistuar, më së shumti, në dhënien e ekspertizës dhe në çështjet e organizimit.

Të dhënat statistikore për aktivitetet trajnuese në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë i gjeni si më poshtë:




Grafiku nr. 1. Numri i trajnimeve sipas muajve për vitin akademik 2024-2025

Tabela nr. 1. Shpërndarja mujore e aktiviteteve për vitin akademik 2024-2025

Nr.	Muajt	Trajnime SHM	Trajnime të mbështetura/të zhvilluara me donatorë	Trajnim Trajnerësh
1	Shtator 2024	0	3	0
2	Tetor 2024	16	2	1
3	Nëntor 2024	12	5	0
4	Dhjetor 2024	10	10	1
5	Janar 2025	15	1	0
6	Shkurt 2025	14	4	0
7	Mars 2025	15	4	1
8	Prill 2025	15	7	0
9	Maj 2025	15	2	0
10	Qershor 2025	19	6	2
11	Korrik 2025	2	3	1
		133	47	

Raporti i trajnimeve në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë me ato të organizuara vetëm nga ShM



■ Trajnime SHM ■ Trajnim me donatorë

Grafiku nr. 2. Trajnimet në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë/trajnime të organizuara nga SHM-ja, 2024-2025

Në një vështrim krahasues me vitin akademik 2023-2024, vihet re një rritje e aktiviteteve trajnuese të zhvilluara në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë.

Disa nga trajnimet me bashkëpunëtorë paraqiten si më poshtë:

- Shkolla e Magjistraturës, në bashkëpunim me Prezencën e OSBE-së në Tiranë, zhvilloi në datat 7 dhe 8 Nëntor 2024, aktivitetin trajnues me temë: *“Hetimi dhe Gjykimi i Veprave Penale lidhur me Prokurimin Publik dhe Korrupsionin”*, në Tiranë.



Foto 3. “Hetimi dhe Gjykimi i Veprave Penale lidhur me Prokurimin Publik dhe Korrupsionin”

- Shkolla e Magjistraturës në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI), së bashku me Projektin Shqiptaro-Zviceran për Pronësinë Intelektuale (ALSIP) , zhvilloi më datë 8 nëntor 2024, aktivitetin trajnues me temë: *“Praktika gjyqësore e Gjykatës Administrative në lidhje me Pronësinë Industriale dhe Intelektuale”*, në Tiranë.



Foto 4. “Praktika gjyqësore e Gjykatës Administrative në lidhje me Pronësinë Industriale dhe Intelektuale”

- Shkolla e Magjistraturës, më datat 10-11 dhjetor 2024, në bashkëpunim me EIPA, Institutin Evropian të Administratës Publike, në mbështetje të Programit të Asistencës Teknike të Luksemburgut për Shqipërinë, zhvilloi aktivitetin trajnues me temë: *“Paragjykimet dhe Njëanshmëria Njohëse në Procesin Gjyqësor”*, pranë ambienteve të Shkollës së Magjistraturës, në Tiranë.



Foto 5. “Paragjykimet dhe Njëanshmëria Njohëse në Procesin Gjyqësor”

- Shkolla e Magjistraturës, në bashkëpunim me UNCTAD, në datat 20 dhe 21 janar 2025, zhvilloi aktivitetin trajnues me temë “Çështjet e konkurrencës në sektorët e rregulluar, sektorët e rregulluar dhe parimi i konkurrencës së lirë, aksesit në treg, konkurrenca dhe çmimet e përcaktuara, diskutimi i rasteve praktike në fushën e energjisë dhe telekomunikacionit. Çështjet e konkurrencës në tregun digjital, natyra e tregut digjital, pozitat dominuese, kontrolli i grupimeve, balanca midis konkurrencës dhe zhvillimit teknologjik, diskutimi i rasteve praktike.”, pranë ambienteve të Shkollës së Magjistraturës, në Tiranë.



Foto 6. “Çështjet e konkurrencës”

- Këshilli i Evropës në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, në datat 24 dhe 25 shkurt 2025, organizuan trajnimin me temë: *“Zbatimi i jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut lidhur me çështjet e korrupsionit të nivelit të lartë, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”*, në Tiranë.



Foto 7. *“Zbatimi i jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut lidhur me çështjet e korrupsionit të nivelit të lartë, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”*

- Shkolla e Magjistraturës në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, më datë 13 mars 2025, zhvilloi aktivitetin trajnues me temë: *“Siguria e gazetarëve me fokus në standardet anti-SLAPPS”*, pranë ambienteve të Shkollës së Magjistraturës, në Tiranë.



Foto 8. “Siguria e gazetarëve me fokus në standardet anti-SLAPPS

- Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë, në bashkëpunim të ngushtë me Shkollën e Magjistraturës, organizoi trajnimin me temë: “Garantimi i integritetit të zgjedhjeve, ndjekja, hetimi dhe gjykimi i krimeve zgjedhore”, më datat 10-11 prill 2025, në Tiranë.



Foto 9. “Garantimi i integritetit të zgjedhjeve, ndjekja, hetimi dhe gjykimi i krimeve zgjedhore”

- Më 20 qershor 2025, Shkolla e Magjistraturës, në bashkëpunim me Akademinë e së Drejtës Evropiane (ERA), organizoi trajnimin me temë: “Lufta kundër korrupsionit në Bashkimin Evropian dhe në Shqipëri”, i zhvilluar në ambientet e Shkollës së Magjistraturës.



Foto 10. “Lufta kundër korrupsionit në Bashkimin Evropian dhe në Shqipëri”

2.8 TEMAT E TRAJNIMEVE

Trajnimet e formimit vazhdues kanë si synim të jenë të specializuara dhe sa më pranë nevojave të sistemit të drejtësisë me qëllim forcimin e kapaciteteve të tij. Për këtë arsye, SHM-ja ka miratuar programin tematik 3-vjeçar 2024-2027, i cili përmban module dhe tema të mëvetshme trajnimi në disa fusha:

- E drejtë private², 9 module dhe 5 trajnime të mëvetshme;
- E drejtë publike³, 28 module dhe 7 trajnime të mëvetshme;
- Çështje të etikës, integritetit, deontologjisë dhe komunikimit;
- Çështje të menaxhimit gjyqësor.

Kështu, gjatë vitit akademik 2024-2025, SHM-ja ka organizuar trajnime të posaçme të orientuara në fusha të ndryshme të së drejtës dhe për grupe të caktuara subjektesh, si për shembull:

- ***trajnime për të drejtat e njeriut:*** E drejta për informim dhe mbrojtja e të dhënave personale. Ndikimi i legjislacionit të ri të mbrojtjes së të dhënave personale në punën e gjyqtarëve, prokurorëve dhe nëpunësve të caktuar për marrëdhëniet me publikun dhe median. Gjyqtari për Median dhe roli i tij në informimin e medias dhe publikut për çështjet gjyqësore. Roli i gjyqtarit për median në forcimin e besimit të publikut tek drejtësia. Rregullat bazë të vendosura nga Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), për komunikimin në fushën e Drejtësisë; Komunikimi i gjyqësorit dhe i prokurorisë me mediat dhe publikun.

² Shënim: Në fushën e së drejtës private përfshihen module dhe tema në të drejtë civile, materiale dhe procedurale, në të drejtë familjare, në të drejtë tregtare dhe në të drejtën e punës.

³ Shënim: Në fushën e së drejtës publike përfshihen module dhe tema në të drejtë penale, materiale dhe procedurale, në të drejtë administrative, në të drejtë kushtetuese dhe të drejtat e njeriut.

E drejta për informim dhe mbrojtja e të dhënave personale gjatë veprimtarisë gjyqësore. Ndikimi i legjislacionit të ri të mbrojtjes së të dhënave personale në punën e gjyqtarëve, prokurorëve dhe nëpunësve të caktuar për marrëdhëniet me publikun dhe median; Ndalimi i diskriminimit në ligjin ndërkombëtar, evropian dhe shqiptar. Standardet dhe barra e provës. Marzhet e vlerësimit. Arsytimi i vendimit nga gjykata. E drejta e ankimit; Perspektiva gjinore dhe diskriminimi. Shpërblimi i dëmit në rastet e diskriminimit; Komisioneri për diskriminimin. Pozicioni procedural i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Gjykatë. Natyra e vendimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Praktika e GJEDNJ dhe GJED dhe gjykatave në Republikën e Shqipërisë lidhur me parimin e barazisë dhe mos diskriminimit.

- ***trajtime për temat që lidhen me korrupsionin dhe trajtime për SPAK-un:*** Trajnim mbi zbatimin e Jurisprudencës së GJEDNJ-së për çështjet e korrupsionit, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit; Individualizimi i figurave të veprës penale të korrupsionit. Tipizimi i korrupsionit aktiv, ndërmjetësimit për korrupsion dhe korrupsionit. Përcaktimi i përgjegjësisë penale të ndërmjetësit korruptiv. Fusha e zbatimit të nenit 245/1 në raport me figurat e posaçme të veprave penale të korrupsionit. Veprimet hetimore dhe mjetet e posaçme të kërkimit të provës në veprat penale të korrupsionit; Shkelja e parimit të trajtimit të barabartë në procedurat e prokurimit publik si vepër penale. Hetimi efektiv dhe gjykimi bazuar në parashikimet e legjislacionit të prokurimit publik dhe Kodit Penal.
- ***trajtime për administratën gjyqësore dhe kancelarët:*** Roli i Këshillit të Gjykatës në përmirësimin e performancës; Roli i Kancelarit të Gjykatës në rritjen e treguesve të performancës së administratës gjyqësore dhe zgjerimin e aksesit në gjykatë; Roli i ndihmës efektive të administratës gjyqësore në rritjen e eficiencës së kohës gjyqësore;
- ***trajtime për “soft skills”, etikë, sjellje dhe komunikim:*** Trajnim mbi Guidën për Kodin e Ri të Etikës; Integriteti si harmonizim dhe respektim i vazhdueshëm të vlerave etike, parimeve dhe normave të përbashkëta që mbështesin dhe përcaktojnë prioritetin e interesit publik mbi interesin privat. Integriteti si forcë për të punuar në një situatë edhe nëse ajo është e pakëndshme. Integriteti një zgjedhje personale, një praktikë e të qenit të ndershëm dhe e të treguarit të një besnikërie të qëndrueshme dhe të pakompromis ndaj parimeve dhe vlerave të forta morale dhe etike; Paanshmëria; Paragjykimi dhe njëanshmëria e pavetëdijshme, dy koncepte apo procese që mund të ndikojnë në mënyrë të thellë në mënyrën si njerëzit perceptojnë dhe interpretojnë botën rreth tyre dhe mund të kenë pasoja të rëndësishme për sjelljen dhe vendimet e tyre. Rëndësia që njerëzit të jenë të vetëdijshëm për këto procese dhe të punojmë për të minimizuar ndikimin e tyre në mënyrën tonë të menduarit dhe të sjelljes.; Paragjykimi dhe njëanshmëria e pavetëdijshme (konjitive) në gjykim si procese që ndikojnë në mënyrën se si magjistratët analizojnë dhe vendosin rreth rasteve gjyqësore. Procese të lidhura me perceptimet, besimet dhe përvojat e tyre të paracaktuara dhe mund të ndikojnë në objektivitetin e vendimeve të tyre;. Reduktimi i efektit të paragjyqimeve dhe njëanshmërisë së pavetëdijshme në gjykim, për të minimizuar ndikimin: e stereotipeve dhe përvojave personale; e mediave dhe shoqërisë; e presionit profesional dhe kulturës gjyqësore si dhe njohurive të përziera me emocionet; Inteligjenca

emocionale dhe stresi: Inteligjenca emocionale si aftësi e njeriut: për të kuptuar dhe menaxhuar ndjenjat e veta dhe të tjerëve në mënyrë efektive; për të njohur, vlerësuar dhe përdorur ndjenjat me qëllim drejtimin e sjelljes së individit dhe menaxhuar marrëdhëniet me të tjerët; për të përballuar sfidat dhe stresin në mënyrë të suksesshme, duke pasur marrëdhënie më të mira me të tjerët dhe arritur sukses në punë dhe në jetë; Komunikimi institucional i magjistratit; Lidershipi në gjykatë dhe prokurori, thelbësor për funksionimin e drejtësisë në shoqëri. Lidershipi në gjykatë dhe prokurori luan një rol kyç në mbrojtjen e drejtësisë dhe sigurimin e respektimit të ligjit për të gjithë qytetarët. Lidershipi në gjykatë dhe prokurori shërben si model për standardet e integritetit dhe profesionalizmit në sistemin e drejtësisë.; Integriteti, kompetenca, pavarësia, transparenca dhe efikasiteti, si karakteristikat e një lidershipi të fortë në gjykatë dhe prokurori. Lidershipi duhet të jenë në gjendje të menaxhojë dhe drejtojë proceset gjyqësore dhe prokuroriale në mënyrë efektive dhe të sigurojë që drejtësia të bëhet në një kohë të arsyeshme.

- ***trajnime të fokusuara për gjyqtarë:*** Shkrimi dhe arsyetimi ligjor. Veçoritë e vendimit të gjyqtarit të hetimeve paraprake, seancës paraprake dhe gjyqtarit të themelit në raport me kërkesat e palëve si refleksion i arsyetimit në pavarësinë e gjykatës; Procesi i rishikimit të vendimeve të Autoriteteve Kontraktore në shkallë administrative dhe ankimi në gjykatë. Rëndësia e shpejtësisë në gjykimin gjyqësor për vendimmarrjet e Komisionit të Prokurimit Publik.
- ***trajnime të fokusuara për prokurorë:*** Krimi Kibernetik; Trajnim mbi vendin e ngjarjes; Liria e shprehjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kufizimet në lirinë e shprehjes për gjyqtarët dhe prokurorët. Sekretet hetimor dhe liria e shprehjes; Diskriminimi dhe integriteti; Kuadri global dhe evropian për luftën kundër korrupsionit.

2.9 TRAJNIME TRAJNERËSH

Në vitin akademik 2024-2025 ka pasur gjithsej 6 (gjashtë) aktivitete trajnimi trajnerësh, të cilat kanë qenë me shumë interes për pjesëmarrësit për shkak se janë fokusuar më tepër në zhvillimin e aftësive të tyre trajnuese dhe në metodologjinë e zhvillimit të trajnimit sipas të cilës synohet të përçohen njohuri, aftësi dhe kompetenca të paracaktuara në kurrikulën dhe objektivat e një aktiviteti trajnues, konkretisht:

- “*Lehtësuesit e rinj*”, në bashkëpunim me IRZ, datë 24 tetor 2024



Fotot nr. 11. ToT, Lehtësuesit e rinj

- *“Paditë Strategjike kundër pjesëmarrjes së Publikut”, në bashkëpunim me PRO-FREX-A, në datat 5 – 6 dhjetor 2024*
- *“Gjykimi civil për Rops dhe transferimet sektoriale”, në bashkëpunim me SSR, në datat 11-12-13 mars 2025.*



Foto nr. 12. ToT, Gjykimi civil për Rops dhe transferimet sektoriale

- *“Njohuri mbi aftësitë e TI për Magjistratët”, në bashkëpunim me KE, në datë 5 qershor 2025*
- *“Rishikimi i Programit të Formimit Fillestar”, në bashkëpunim me Projektin e Binjakëzimit – “Forcimi i efikasitetit, integritetit dhe profesionalizmit të sistemit të*

drejtësisë duke përmirësuar kapacitetet e Shkollës Shqiptare të Magjistraturës", në datat 24-26 qershor 2025



Foto nr. 13, ToT, Rishikimi i Programit të Formimit Fillestar

- “Trajnim Trajnerësh për dhunën në familje”, në bashkëpunim me Projektin e Binjakëzimit: “Forcimi i efikasitetit, integritetit dhe profesionalizmit të sistemit të drejtësisë duke përmirësuar kapacitetet e Shkollës Shqiptare të Magjistraturës, në datat 14-15 korrik 2025



Foto nr. 14, ToT, Për dhunën në familje

2.10 EKSPERTIZA

Aktiviteti trajnues dhe cilësia e tij janë të lidhura ngushtësisht me cilësinë e ekspertizës. Shkolla e Magjistraturës dhe Këshilli Drejtues kanë bërë shumë kujdes që të përzgjedhin në cilësinë e ekspertit, profesionistët më të mirë të fushave të caktuara, pjesa më e madhe e të cilëve kanë qenë magjistratë në detyrë, por edhe të pajisur me aftësi pedagogjike, apo që janë trajnuar sipas formatit të trajnimit të trajnerëve. Shkolla ka synuar që pjesa më e madhe e ekspertizës të jetë nga magjistratët në detyrë. Ka qenë gjithashtu shumë i çmuar dhe i kërkuar edhe kontributi i ekspertëve të fushave të ndryshme, pedagogë të nderuar, studiues të mirënjohur të së drejtës etj.

Tabela dhe grafiku me poshtë, paraqet, në mënyrë të përmbledhur, llojin e ekspertizës në Shkollë dhe raportin mes tyre. Vihet re që magjistratët zënë vendin kryesor si ekspertë në Programin e Formimit Vazhdues, ku dominojnë magjistratët gjyqtarë.

Gjithashtu vërehet një rritje e ekspertizës së huaj në krahasim me një vit më parë, kjo si rrjedhojë e rritjes së bashkëpunimeve me organizatat ndërkombëtare për mbështetje me ekspertizë ndërkombëtare të trajnimeve të programit të formimit vazhdues.

Tabela nr. 2 Ekspertët sipas kategorive, viti akademik 2024-2025

Nr.	Angazhimi i ekspertëve sipas kategorive	
1	Gjyqtarë	79
2	Prokurorë	23
3	Pedagogë të Brendshëm	8
4	Specialistë juristë	16
5	Specialistë fushe	2
6	Ekspertë të huaj	51
	Total ekspertë	179



Grafik. Nr. 3. Ekspertët sipas kategorive, viti akademik 2024-2025


Duhet theksuar se i njëjti kujdes është treguar edhe gjatë këtij viti akademik në rastin e përfshirjes së ekspertizës së huaj. Partnerëve ndërkombëtarë u janë kërkuar të dhëna të sakta dhe të verifikueshme mbi përvojën profesionale të ekspertëve të propozuar prej tyre, me qëllim garantimin e cilësisë dhe profesionalizmit në përmbajtjen e aktiviteteve trajnuese.

Një vëmendje dhe kujdes i veçantë i kushtohet edhe përzgjedhjes dhe caktimit të lehtësuesve dhe moderatorëve. Por, ndërsa moderatorët janë pjesë e panelit vetëm në aktivitete të një rëndësie të caktuar, apo që lidhen me veçanti të formatit të aktivitetit, dhe kanë qenë të rrallë në këtë vit, për lehtësuesit është treguar kujdes i posaçëm për shkak se lidhja e tyre me Shkollën synohet të jetë një lidhje afatgjatë, e specializuar në fushën e interesit të tyre dhe në atë çfarë Shkolla sheh si prioritare dhe shikohet si një investim që do t'i shërbejë, jo vetëm formimit vazhdues, por edhe atij fillestar, edhe kërkimeve e publikimeve.

Tabela dhe grafiku me poshtë paraqesin ndarjen sipas profileve të lehtësuesve të angazhuar në programin e formimit vazhdues, për vitin akademik 2024-2025.

Tabela nr. 3. Lehtësuesit sipas kategorive, viti akademik 2024-2025

Nr.	Angazhimi i lehtësuesve sipas kategorive	
1	Gjyqtarë	35
2	Prokurorë	20
3	Specialistë juristë	5
4	Specialistë fushe	4
	Total lehtësues	64



Grafik nr. 4. Lehtësuesit sipas kategorive, viti akademik 2024-2025

Ekspertët dhe lehtësuesit i nënshtrohen një procesi të vazhdueshëm vlerësimi nga ana e Shkollës së Magjistraturës, i cili përfshin disa komponentë thelbësorë, si: seriozitetin në përmbushjen e angazhimeve të marra; bashkëpunimin me panelin dhe me sektorët përkatës të Shkollës; ndërveprimin me auditorin; cilësinë dhe përgatitjen e materialeve trajnuese; dorëzimin në kohë të dokumentacionit dhe materialeve përkatëse; si dhe vlerësimet anonime të pjesëmarrësve në fund të çdo aktiviteti.

Edhe gjatë vitit akademik 2024–2025, Programi i Formimit Vazhdues është përballur me vështirësi në lidhje me angazhimin e ekspertëve dhe lehtësuesve, për shkak të vijimit të procesit të rivlerësimit kalimtar (vetingut), lëvizjeve të shpeshta brenda sistemit si dhe mbingarkesës në punë. Kjo ka sjellë nevojën për ndryshime të herëpashershme në përbërjen e paneleve dhe një numër më të kufizuar trajnerësh në dispozicion. Megjithatë, një pjesë e mirë e ekspertëve të përfshirë kanë qenë bashkëpunëtorë afatgjatë të Shkollës, me përvojë të konsoliduar në fushat përkatëse.

Gjatë këtij viti akademik, vijoi të përdoret si pjesë e dokumentacionit të çdo aktiviteti trajnues Formulari i Vlerësimit për ekspertët dhe lehtësuesit e panelit. Edhe pse plotësimi i tij nuk është i detyrueshëm, qëllimi kryesor i këtij formulari është mbledhja e feedback-ut mbi ecurinë e përgjithshme të trajnimit nga një këndvështrim profesional të brendshëm, si dhe vlerësimi i bashkëpunimit mes anëtarëve të panelit.

Nëpërmjet këtij instrumenti, ekspertët dhe lehtësuesit japin vlerësime mbi: përshtatshmërinë e kohës së trajnimit dhe ndarjen e saj ndërmjet panelistëve; arritjen e objektivave të trajnimit; nivelin e interesit dhe bashkëpunimit të pjesëmarrësve; cilësinë e diskutimeve të nxitura në auditor; mbështetjen logjistike dhe organizative të ofruar nga Shkolla; si dhe përmbushjen e pritshmërive të tyre profesionale.

Gjithashtu, ekspertët japin vlerësime për bashkëpanelistët e tyre lidhur me bashkëpunimin, nivelin e angazhimit për arritjen e qëllimeve të trajnimit, aftësinë për të nxitur debat dhe diskutim në auditor, si dhe njohuritë profesionale mbi temën e trajtimit.

Referuar formularëve të vlerësimit të plotësuar nga pjesëmarrësit në aktivitetet trajnuese, ekspertët/lehtësuesit janë vlerësuar shumë mirë në disa komponentë kyç. Në veçanti, ata janë vlerësuar për: (1) nivelin e lartë të njohurive mbi temën e trajnuar; (2) aftësinë për të inkurajuar diskutimin dhe debatin në auditor; si dhe (3) aftësinë për të nxitur kërkimin dhe thellimin mbi temën, duke ofruar materiale të përgatitura që u kanë shërbyer drejtpërdrejt pjesëmarrësve në punën e tyre të përditshme.

2.11 PJESËMARRJA E GJYQTARËVE, PROKURORËVE DHE PROFESIONISTËVE TË TJERË TË SË DREJTËS

Shkolla ndjek procedurat që parashikon ligji për pjesëmarrje në programin e formimit vazhdues.

Bashkëpunimi me gjykatat dhe prokuroritë

Në zbatim të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kryetarët e gjykatave dhe drejtuesit e prokurorive, ashtu si edhe Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, kanë detyrimin ligjor për të shprehur mendimin e tyre në lidhje me Programin e Formimit Vazhdues. Dhënia e këtij mendimi institucional kontribuon ndjeshëm në përmirësimin e procesit të planifikimit dhe organizimit të trajnimeve, duke rritur efikasitetin dhe duke shmangur vonesat apo mbivendosjet në kalendarin e aktiviteteve.

Duke qenë në kontakt të drejtpërdrejtë me problematikat e përditshme të sistemit gjyqësor dhe atij të prokurorisë, drejtuesit e këtyre institucioneve luajnë një rol të rëndësishëm si “urë lidhëse” me Shkollën e Magjistraturës, duke mundësuar identifikimin më të saktë të nevojave për trajnim dhe adresimin e temave me rëndësi praktike më të lartë për punën gjyqësore dhe atë të prokurorisë. Ky bashkëpunim i vazhdueshëm ndihmon Shkollën të përshtatë përmbajtjen e programeve me zhvillimet më të fundit në praktikë dhe legjislacion.

Edhe gjatë vitit akademik 2024–2025, kalendarin vjetor i trajnimeve, së bashku me temat e propozuara, iu përcoll çdo kryetari gjykate dhe drejtuesi prokurorie në nivel rrethi dhe apeli. Si çdo vit, dokumentacioni shoqërohej me formularin e aplikimit për gjyqtarët dhe prokurorët e gjykatave dhe prokurorive të rretheve dhe të apelit. Në këtë kuadër, iu kujtua rëndësia e shmangies së përzgjedhjes së të njëjtave tema trajnimi brenda vitit, si dhe respektimi i detyrimit të përcaktuar në nenin 5 të ligjit nr. 96/2016, lidhur me numrin e ditëve të trajnimit gjatë një viti dhe në ciklin pesëvjeçar të formimit vazhdues.

Bashkëpunimi me gjykatat dhe prokuroritë ka vijuar të jetë shumë i mirë dhe konstruktiv, duke reflektuar një angazhim të qëndrueshëm institucional në mbështetje të misionit të Shkollës së Magjistraturës për forcimin e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

2.12 ROLI I SEKTORIT TË FORMIMIT VAZHDES


Koordinimi dhe organizimi i të gjitha proceseve që lidhen me realizimin e kalendarit dhe aktiviteteve trajnuese kryhen nga Sektori i Formimit Vazhdues, nën drejtimin e Pedagogut Përgjegjës për Formimin Vazhdues dhe Drejtorit të Formimit Profesional. Procesi mbështetet më tej nga vendimmarrjet e Drejtorit të Shkollës, Këshillit Pedagogjik dhe Këshillit Drejtues, në përputhje me strukturën dhe procedurat e brendshme të institucionit.

Gjatë vitit akademik 2024–2025, Sektori i Formimit Vazhdues ka vijuar të ketë një ngarkesë të lartë pune, për shkak të intensitetit të aktiviteteve trajnuese dhe detyrimeve shtesë që lidhen me administrimin e të dhënave dhe informacionit në Sistemin e Menaxhimit të Veprimtarisë së Shkollës së Magjistraturës. Ky proces kërkon koordinim të vazhdueshëm ndërmjet sektorëve të brendshëm, ekspertëve dhe institucioneve bashkëpunuese, duke siguruar saktësi dhe efikasitet në raportimin dhe dokumentimin e veprimtarive trajnuese.

Disa të dhëna mbi pjesëmarrjen

- Fokusi kryesor i PFV-së janë magjistratët në detyrë. Për këtë arsye, edhe numri më i lartë i pjesëmarrësve në trajnime është nga radhët e magjistratëve. Këtë vit akademik, kemi vënë

re një rritje të numrit të magistratëve të cilët kanë ndjekur trajnimet vazhduese. Grafiku në vijim bën një ndarje të subjekteve pjesëmarrëse në aktivitete sipas kategorive.



Grafik nr. 5. Pjesëmarrja sipas kategorive në aktivitetet për vitin 2024-2025

Gjyqtarët, prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe kategori të tjera të përfshira në aktivitetet e Programit të Formimit Vazhdues gjatë vitit akademik 2024–2025 janë regjistruar në Sistemin e Menaxhimit të Veprimtarisë së Shkollës së Magistraturës (SMVSHM), në përputhje me listat e prezencës të mbajtura për çdo ditë dhe sesion trajnimi.

Sekretaria shkencore e Formimit Vazhdues ka vijuar të ndjekë me prioritet komponentin e frekuentimit, duke mbajtur evidenca të sakta dhe të përditësuara për pjesëmarrjen në çdo aktivitet. Ashtu si në vitet e mëparshme, për çdo ditë trajnimi janë mbajtur dy lista prezence – për sesionin e paradites dhe atë të pasdites – të nënshkruara nga pjesëmarrësit, me qëllim garantimin e transparencës dhe saktësisë në raportim.


Gjatë vitit akademik 2024–2025, është vërejtur se pjesëmarrësit kanë ndjekur në mënyrë të rregullt aktivitetet trajnuese. Megjithatë, një nga problematikat e identifikuara mbetet mospërputhja ndërmjet numrit të ftesave të dërguara dhe pjesëmarrjes faktike të gjyqtarëve dhe prokurorëve në disa prej trajnimeve të planifikuara. Kjo është ndikuar kryesisht nga ngarkesa e punës dhe angazhimet institucionale të pjesëmarrësve potencialë.

Për të adresuar këtë sfidë, Shkolla e Magistraturës ka vijuar përpjekjet për të forcuar komunikimin me gjykatat dhe prokuroritë, me synimin që në të ardhmen të krijohet një mekanizëm më i qëndrueshëm bashkëpunimi dhe shkëmbimi informacioni mbi nevojat për trajnim dhe përfshirjen e pjesëmarrësve.

Pjesëmarrja në Programin e Formimit Vazhdues përbën një komponent të rëndësishëm të sistemit të vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, përveç faktit që trajnimet ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e performancës profesionale dhe cilësinë e ushtrimit të funksionit. Në këtë kuadër, bashkëpunimi dhe mbështetja nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) mbetet thelbësor për zbatimin sa më efektiv të Programit të Formimit Vazhdues, në interes të Shkollës së Magistraturës dhe të vetë sistemit të drejtësisë.

Numri i aplikuesve për çdo aktivitet mesatarisht shkon nga një minimum prej 25 (njëzet e pesë) deri në një maksimum prej 60 (gjashtëdhjetë) gjyqtarë/prokurorë, me përjashtim të rasteve kur kërkesat janë më të ulëta apo më të larta. Megjithatë, ditën e aktivitetit, numri i pjesëmarrësve ka shkuar në një mesatare, prej 20 (njëzetë) pjesëmarrësish, në një aktivitet.

Gjithashtu, konstatohet se ka gjyqtarë e prokurorë që nuk kanë aplikuar asnjëherë dhe nuk kanë marrë pjesë në asnjë sesion trajnues. Këta pa dyshim përbëjnë një grup të kufizuar, dhe numri është shumë më i ulët se në vitet paraardhëse, por ky fenomen duhet të konsiderohet seriozisht nga KLGJ-ja dhe KLP-ja. Shkolla e Magjistraturës, në bashkëpunim me KLGJ-në dhe KLP-në, do të vijojë të angazhohet për të siguruar një pjesëmarrje më të madhe në aktivitetet trajnuese nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve.




Grafik nr. 8. Të dhëna mbi pjesëmarrjen e magjistratëve në trajnimet vazhduese.

Të dhëna më të detajuara për gjyqtarët dhe prokurorët më vete, jepen në tabelën dhe grafikun si vijon:

Tabela nr. 4. Ditët e pjesëmarrjes në aktivitetet trajnuese për çdo gjyqtar dhe prokuror

Ditët	Gjyqtarë	Prokurorë
0-4 ditë	127	105
Mbi 5 ditë	150	124



Grafik nr. 9. Ditët e trajnimit për kategoritë gjyqtar dhe prokuror për vitin akademik 2024-2025

Nga të dhënat e pasqyruara edhe në grafik, të dhënat e përpunuara nuk kanë shumë ndryshim në raport me vitin e kaluar. Vazhdon të ketë një rritje të frekuentimit të trajnimeve në Shkollë nga ana e gjyqtarëve, si dhe numri i trajnimeve të frekuentuara nga gjyqtarët dhe prokurorët ka qenë relativisht i lartë, duke pasur parasysh se ngarkesa e tyre në punë ka qenë shumë e madhe.

Viti akademik 2024–2025 ka treguar një dinamikë të lartë në zhvillimin e aktiviteteve trajnuese dhe një përmirësim të mëtijshëm në organizimin institucional dhe bashkëpunimin me aktorët e sistemit të drejtësisë. Përvoja e këtij viti do të shërbejë si bazë për rishikimin dhe përsosjen e mëtijshme të programeve të formimit vazhdues, duke synuar që trajnimi i magistratëve të jetë gjithnjë më i lidhur me nevojat reale të praktikës gjyqësore dhe të sistemit të drejtësisë në tërësi.

Kreu 3

Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë 2024-2025

3. BASHKËPUNIMI ME PARTNERËT NDËRKOMBËTARË

3.1 Aktivitete të rëndësishme gjatë vitit akademik 2024-2025

- Lançimi i Projektit të Binjakëzimit “Fuqizimi i Efikasitetit, Integritetit dhe Profesionalizmit në sistemin e drejtësisë me anë të përmirësimit të kapaciteteve të Shkollës Shqiptare të Magjistraturës.

Me mbështetjen e Bashkimit Evropian, filloi zbatimin në Shkollën e Magjistraturës Projekti i Binjakëzimit “Fuqizimi i efikasitetit, integritetit dhe profesionalizmit në sistemin e drejtësisë me anë të përmirësimit të kapaciteteve të Shkollës Shqiptare të Magjistraturës.”, që është një binjakëzim me 3 institucione kombëtare të trajnimit gjyqësor në BE – me Shkollën Kombëtare të Magjistraturës të Francës - ENM, me Shkollën e Lartë të Magjistraturës të Italisë - SSM dhe Qendrën e Studimeve Gjyqësore të Mbretërisë së Vendeve të Ulëta – SSR.

Nëpërmjet ndërveprimit me institucionet kryesore të trajnimit gjyqësor në Bashkimin Evropian, Projekti synon të forcojë efikasitetin, integritetin dhe profesionalizmin e Shkollës së Magjistraturës gjatë periudhës 2024-2026 duke reformuar Programet e Formimit Profesional Fillestar dhe të Vazhduar si dhe Procesin e Rekrutimit në Shkollë. Duke përmirësuar kapacitetet e shkollës për të tërhequr më shumë magjistratë të kualifikuar, do të jemi në gjendje të prodhojmë grupe magjistratësh e kategorish të tjera, me cilësi më të lartë, për të dhënë një kontribut më të mirë në forcimin e kapaciteteve të sistemit gjyqësor.



• Leksion i hapur “Integriteti dhe Lidershipi në drejtimin e Prokurorisë”

Shkolla e Magjistraturës, në 26 nëntor 2024, në bashkëpunim me Projektin EU4FAST organizoi aktivitetin me temë: “*Integriteti dhe lidheria në përgjithësi. Drejtimi i prokurorisë në veçanti*” me kandidatët për magjistratë të formimit fillestar. Aktiviteti konsistoi në një leksion të hapur të z. Ben Sëagerman, prokuror holandez, i njohur tashmë në Shqipëri për shkëmbimin e eksperiencave midis prokurorëve, krijimin e urave lidhëse për bashkëpunim ndërkombëtar, i angazhuar në projekt për çështje të trafikimit të personave dhe emigracionit të paligjshëm.

Në aktivitet kandidatët për magjistratë u njohën me tematikat:

- çfarë është lidheria dhe si duhet t’i qasemi integritetit si një instrument normativ;
- roli i drejtimit të prokurorisë (dhe çfarë kërkon ai nga organizata dhe nga palët e tjera të interesuara siç është policia);
- si mund të paraqitet çështja gjyqësore bindshëm dhe me efektivitet në gjykatë;
- gjendja aktuale të çështjeve në prokurorinë shqiptare.

Aktiviteti u konsiderua një vlerë e shtuar përse i takon përfitimeve dhe dobishmërisë në kryerjen e veprimeve të përditshme të punës së magjistratit në detyrë.



• Gjyqi Imitues “Trafikimi i Personave”

Në datat 4-5 dhjetor 2024, u zhvillua gjyqi imitues me temë: “Trafikimi i Personave”, në bashkëpunim me Prezencën e OSBE.

Ky aktivitet në formatin “gjyq imitues” për çështjet e trafikimit të personave për kandidatët për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës ofroi një mundësi trajnimi nëpërmjet një metodologjie që i qëndron afër realitetit të sallës së gjyqit, për të mësuar dhe provuar zgjidhje të reja në gjykimet penale dhe posaçërisht në veprat e trafikimit të personave, të njohura për kompleksitetin e hetimit dhe gjykimet.

Objekti i këtij aktiviteti ishte të ofronte ndihmë që kandidatët të kuptojnë problematikat dhe sfidat tipike në çështjet e trafikimit të personave si dhe t’u mundësojë të mprehin aftësitë për trajtimin e këtyre çështjeve.

Ky trajnim u zhvillua në kuadrin e projektit “Avancimi i kapaciteteve trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe Akademisë së Sigurisë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore”, që u zbatua me mbështetjen e qeverive të Shteteve të Bashkuara, Norvegjisë dhe Italisë.



- **Partneriteti me Zyrën Gjyqësore të Britanisë së Madhe**

Në kuadër të Partneritetit Shqipëri-Mbretëri e Bashkuar, Ambasada Britanike në partneritet me Zyrën Gjyqësore Britanike mundësuan zhvillimin e 2 vizitave të punës për gjyqtarët shqiptarë, që u zhvilluan gjatë datave 11-15 Nëntor dhe 13-17 Janar 2025.

Vizitat e punës ofruan trajnim dhe mentorim për gjyqtarët pjesëmarrës, si dhe ndarjen e praktikave më të mira në zbatimin e shtetit të së drejtës më efektivisht në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.



- **Aktiviteti i Përbashkët me Akademinë e Drejtësisë së Kosovës “Aftësitë e Prokurorëve për Paraqitjen e Çështjes në Gjyq”**

Me ftesë të Ëorld Jurist Association (ËJA), një organizatë jo-qeveritare me status konsultativ të posaçëm në Këshillin Social Ekonomik të Kombeve të Bashkuara, një përfaqësi e Shkollës së Magjistraturës mori pjesë në punimet e Kongresit Botëror të 19-të të Ligjit. Kongresi u

zhvillua në datat 4-6 Maj 2025 në Santo Domingo, si një aktivitet që mbledhi bashkë udhëheqës botërorë, përfshirë drejtues shtetesh, autoritete shtetërore, gjyqtarë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, akademikë, juristë, aktivistë dhe student të së drejtës.

Aktiviteti trajtoi çështjet më aktuale në formatin e diskutimeve në panele të ndryshme për tematika si shteti i së drejtës dhe pavarësia e gjyqësorit, të drejtat e njeriut dhe liria e shprehjes, etika profesionale dhe forcimi i vlerave kushtetuese, digjitalizimi i drejtësisë, etj. Gjatë aktivitetit përfaqësuesit e Shkollës morën pjesë si folës në 2 panele të rëndësishme si: Paneli 10 – Pavarësia e Gjyqësorit dhe Siguria Personale si dhe paneli 19 – Kontributi i Grave në ruajtjen e shtetit të së drejtës. Tematikat në fokus të aktivitetit u trajtuan nga më shumë se 300 folës dhe panelistë nga më shumë se 70 vende të botës.

Pjesëmarrja në këtë aktivitet ndërkombëtar të ligjit i paraprin përgatitjeve për organizimin e zhvillimin e këtij kongresi në Tiranë në vitin 2027.



• Konkursi Ndërkombëtar THEMIS 2025 – Bashkëpunim me EJTN



Në kuadër të bashkëpunimit me Rrjetin Gjyqësor Evropian të Trajnimeve, në datat 30 qershor – 4 korrik, 2025, Shkolla e Magjistraturës, si çdo vit, mori pjesë në konkursin ndërkombëtar e-THEMIS në gjysëm finalen B e Drejta Familjare Evropiane dhe e BE-së. Konkursi u zhvillua në qytetin e Napolit, Itali.

Në këtë aktivitet, skuadra e Shkollës së Magjistraturës përbëhej nga Tea Take, Ornella Troplini, Aurora Ndreu, kandidatë për magistratë në vitin e dytë të studimeve, nën mentorimin e pedagoges Prof. Dr. Arta Mandro.

„Kufij ndarës – Sfida juridiksionale në çështjet e divorcit të shtetasve shqiptarë që jetojnë në BE“ ishte tema me të cilën u prezantua Shkolla e Magjistraturës në konkursin Themis 2025.

Punimi i realizuar dhe prezantuar nga skuadra e Shkollës së Magjistraturës u vlerësua maksimalisht nga anëtarët e jurisë dhe më konkretisht vlerësimet e marra ishin për një punë origjinale, risitë e sjella në drejtim të krahasimit dhe ndërveprimit ndërmjet ligjit shqiptar dhe atij të BE-së, si dhe njohuritë e thelluara me një anglishte ligjore të shkëlqyer.

- **Konferenca “Dimensioni i Integritetit në funksionin e Magjistratit. Angazhimi ndaj Drejtësisë”**

Në datën 30 qershor 2025, Shkolla e Magjistraturës realizoi Konferencën Kombëtare me tematikë “Dimensioni i Integritetit në funksionin e Magjistratit. Angazhimi ndaj Drejtësisë” në bashkëpunim me Projektin i Binjakëzimit të Bashkimit Evropian, pjesë e së cilës është dhe ceremonia e diplomimit të brezit 2022-2025 e kandidatëve për magjistratë.

Aktivitetin e përshëndetën drejtues dhe personalitete të larta të institucioneve të sistemit të drejtësisë me mesazhet e tyre për integritetin dhe kandidatët që diplomohen.

Konferenca u fokusua në zhvillimin e 3 paneleve, të cilat trajtuan tematikat e:

- profesionalizmit dhe angazhimit ndaj pavarësisë, paanësisë dhe ndershmërisë në kuptimin e aftësive dhe kompetencave të magjistratëve;
- llogaridhënies, kurajës morale dhe respektit për shtetin e së drejtës;
- integritetit dhe rolit social të magjistratit: modeli kulturor dhe ndërveprimi në komunitet.

Aktiviteti u përmbyll me ceremoninë e diplomimit të kandidatëve për magjistratë të brezit 2022-2025, të cilët nisën rrugëtimin e tyre profesional si magjistratë në detyrë.



- **Aktivitet trajnuese i përbashkët me Akademinë e Drejtësisë së Turqisë dhe Akademinë e Drejtësisë së Kosovës**

Në kuadër të bashkëpunimit me Akademinë e Drejtësisë së Republikës së Kosovës dhe Akademinë e Drejtësisë së Republikës së Turqisë, një delegacion i Shkollës së Magjistraturës mori pjesë në Ëorkshop-in Ndërkombëtar Ligjor me tematikë “Combating Drug-related Crimes”. Aktiviteti u zhvillua në vijim të forcimit të bashkëpunimit mes Akademive përkatëse të Drejtësisë nëpërmjet realizimit të programeve të përbashkëta të trajnimit për shkëmbimin e përvojave më të mira profesionale në fusha të ndryshme të ligjit.

Delegacioni nga Shkolla e Magjistraturës përbëhej nga pedagogë të brendshëm dhe 14 kandidatë për magjistratë të profileve gjyqtarë dhe prokurorë në vitin e dytë të studimeve. Aktiviteti u realizua me pjesëmarrjen e ekspertëve nga vendet respektive dhe trajtoi tematika si:

- Krimet e lidhura me lëndët narkotike në kontekstin e të drejtës ndërkombëtare;
- Praktikat e mjekësisë ligjore në krimet e lidhura me lëndët narkotike;
- Metodot efektive të ndjekjes ligjore në krimet e lidhura me lëndët narkotike – praktikat gjyqësore nga Turqia, Kosova dhe Shqipëria;
- Metodot efektive të gjykimit në krimet e lidhura me lëndët narkotike – praktikat gjyqësore nga Turqia, Kosova dhe Shqipëria.

Krahas aktivitetit trajnues u realizuan edhe vizita dhe takime në institucionet e ndryshme të drejtësisë së Kosovës si në Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ministrinë e Drejtësisë, Gjykatën Supreme, Këshillin Gjyqësor, dhe Akademinë e Drejtësisë së Kosovës.



3.2 Perspektiva

Në zbatim të mbështetjes për realizimin e veprimtarisë akademike dhe profesionale të programeve të formimit profesional, bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë synon të realizojë objektivat për mundësimin e zbatimit të aktiviteteve si më poshtë:

1. Realizimi i përmbushjes së detyrimeve të Shkollës së Magjistraturës në kuadër të integritetit të Shqipërisë në BE.
2. Vijimi i përfaqësimit dinjitoz të kandidatëve tanë për magjistratë në Konkursin Ndërkombëtar THEMIS, ku Shkolla në vijimësi ka fituar pozicione të vlerësuara nga juritë e konkursit.
3. Mundësimi i pjesëmarrjes së pedagogëve, ekspertëve, trajnerëve, gjyqtarëve, prokurorëve në aktivitetet trajnuese të institucioneve të ndryshme të trajnimit gjyqësor të BE-së sipas fushave të interesit.
4. Pjesëmarrje e vazhdueshme e kandidatëve për magjistratë në aktivitete ndërkombëtare të organizuara nga organizata trajnimi gjyqësor dhe akademitë e ndryshme gjyqësore në Evropë.
5. Akomodimi dhe harmonizimi i kërkesave për bashkëpunim që vijnë nga donatorë të ndryshëm pa ceduar nga prioritetet e drejtimeve kryesore të proceseve akademike, administrative dhe institucionale të Shkollës, me synimin për të përfituar maksimalisht nga interesi për bashkëpunim i partnerëve ndërkombëtarë.

**Publikimet dhe puna
kërkimore shkencore
2024-2025**

4. PUBLIKIMET DHE PUNA KËRKIMORE SHKENCORE

4.1 Raportim mbi ecurinë e publikimeve dhe kërkimit shkencor për vitin akademik 2024 - 2025

Shkolla e Magjistraturës vazhdoi edhe gjatë vitit akademik 2024-2025 të botojë nën emrin dhe kujdesin e saj revista, tekste dhe libra, të cilët kanë trajtuar probleme ligjore të lidhura ngushtë me programet e lëndëve dhe kurseve të Trajnimit Fillestar e Vazhdues të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke synuar në unifikimin dhe analizimin e praktikës gjyqësore dhe juridike kombëtare e ndërkombëtare, tekstet konsiderohen tekste shkencore dhe me legjislacionin në fuqi. Botimi i këtyre teksteve synon të plotësojë literaturën juridike me njohuri praktike e teorike në ndihmë të gjyqtarëve, prokurorëve që përgatiten rishtas nga Shkolla e Magjistraturës, si dhe në ndihmë të gjyqtarëve e prokurorëve në detyrë, të avokatëve e të përfaqësuesve të tjerë të profesioneve ligjore në procesin e Trajnimit Vazhdues.

Shkolla e Magjistraturës vijon të ndjekë të njëjtat rregulla për procedurën e botimit sipas të cilave të drejtën e pronësisë mbi botimin e parë të tekstit e ka Shkolla e Magjistraturës, e cila ka të drejtën e shpërndarjes së tekstit gjyqtarëve, prokurorëve e juristëve, sipas kushteve të parashikuara⁴ në kontratën e lidhur me autorët. Të drejtën për botim e kanë të gjithë pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm të Shkollës, ekspertët dhe trajnerët e saj, gjyqtarët, prokurorët e kandidatët për magjistratë, autorë nga profesione të tjera në shërbim të sistemit të drejtësisë, kur botimi ka interes për praktikën gjyqësore dhe trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

4.1.1 Botimi i Revistës Shkencore “Jeta Juridike”

Shkolla e Magjistraturës botoi nën emrin dhe kujdesin e saj revistën “*Jeta Juridike*”, revistë periodike katërmujore shkencore, që botohet në shqip dhe një abstrakt në anglisht, si dhe e pajisur me ISSN.

4.1.2 Kriteret e zbatuara për botimet e Shkollës, të Revistës “Jeta Juridike” dhe të teksteve

Bordi i Redaktorëve ka miratuar Rregulloren e revistës shkencore “Jeta Juridike” si dhe ka adoptuar standarde të larta përzgjedhjeje për artikujt që janë botuar në këtë revistë. Kështu disa nga kriteret e zbatuara kanë qenë dhe janë:

⁴ Përmbytja e tekstit përfshin të gjitha elementet e një botimi shkencor, si përsa i përket formës, ashtu edhe përmbytjes. Botimet paraqiten si tekste me natyrë trajnuese, akademike, didaktike e praktike dhe jo më pak se 200 faqe. Teksti është i strukturuar në kapituj, të cilët i përgjigjen strukturës së programit mësimor të lëndës apo kursit përkatës të Trajnimit Fillestar të miratuar nga Këshilli Drejtues i Shkollës, ose në formë monografie kur në to përmbledhen materialet e një seminari të Trajnimit Vazhdues që lidhet me një temë specifike. Çdo tekst ka jo më pak se 30–40 raste të praktikës gjyqësore për ilustrim, të shoqëruara me referencat përkatëse në vendimet e gjykatës. Teksti mund të përgatitet nga një autor apo grup autorësh, të cilët paraqesin kërkesë me shkrim dhe përbërja e grupit të autorëve miratohet paraprakisht nga Drejtoria e Shkollës. Tekstet që paraqiten për t’u miratuar për botim në Shkollën e Magjistraturës nuk duhet të jenë botuar më parë si libër, tekst, apo botim tjetër, si dhe nuk mund të botohen në të ardhmen pa lejen paraprake me shkrim të Drejtorisë së Shkollës dhe Bordit të Redaktorëve. Tekstet botohen me ISBN dhe me një tirazh të paktën 300 kopje.

- Përzgjedhja e botimeve dhe shkrimeve nga autorë që përfaqësojnë personalitete juridike;
- Heterogjeniteti i autorëve. Kështu revista pasqyron shkrime nga juristë të moshave të ndryshme, të profileve të ndryshme, të rretheve të ndryshme;
- Revista ka në numrat e saj edhe përkthime nga autorë të huaj lidhur me shkrime që vlerësohen si të rëndësishme dhe bashkëkohore për t'u trajtuar edhe në kontekstin shqiptar;
- Larmia e temave që prekin aspekte të ndryshme të teorisë dhe praktikës së të drejtës;
- Duke qenë se lexuesi kryesor është menduar se do të jetë gjyqtari apo prokurori, artikujt dhe struktura janë konceptuar në mënyrë të tillë që t'u shërbejnë këtyre juristëve, përveçse juristëve të rinj. Kështu edhe kur artikujt kanë trajtuar çështje të së drejtës ndërkombëtare apo asaj të huaj, gjithmonë ato janë parë edhe nga këndvështrimi i realitetit shqiptar.
- Nga ana tjetër zgjidhen artikuj që të jenë të pasur me shembuj nga praktika.
- Shkrimet janë seleksionuar mbi bazën e risive dhe origjinalitetit shkencor që ato përcjellin te lexuesi dhe janë shmangur shkrimet me ngjyime politike apo emocionale.
- Artikujt janë përzgjedhur edhe mbi bazën e formatit shkencor të paraqitjes së tyre, strukturës, bibliografisë, citimeve etj.

4.1.3 Informacion lidhur me procedurën që ndiqet për botimin shkencor përmes Bordit të Redaktorëve

Bordi i Redaktorëve të Botimeve. Botimet e revistës “Jeta Juridike” dhe të teksteve realizohen me vendim të Bordit të Redaktorëve. Ky është një organ vendimmarrës që përbëhet nga 7-9 anëtarë, të cilët propozohen nga Drejtori i Shkollës së Magjistraturës dhe miratohen nga Këshilli Drejtues i saj. Kriteret e përzgjedhjes së tyre janë përcaktuar në VKM-në nr. 241, datë 6.4.2011 “*Për veprimtarinë akademike, në zbatimin e programit të Formimit Fillestar dhe Vazhdues në Shkollën e Magjistraturës*”.

Bordi i Redaktorëve të revistës “Jeta Juridike”, në përbërjen e vet ka 9 (nëntë) anëtarë si më poshtë, që është miratuar nga Këshilli Drejtues me vendimin nr. 36, datë 22.09.2020, “*Për caktimin e anëtarëve të Bordit të Redaktorëve të revistës “Jeta Juridike” (i ndryshuar)*”, i cili në këtë vendim caktoi zotin Sokol Sadushi, kryeredaktor të revistës.

Prof.asoc.dr. Sokol SADUSHI
Arben RAKIPI
Prof. dr. Aurela ANASTAS
Prof. dr. Mariana SEMINI
Prof. dr. Arta MANDRO
Prof. dr. Skënder KAÇUPI
Prof. dr. Eralda METHASANI
Dr. Dashamir KORE

Gjatë vitit akademik 2024-2025 Bordi i Redaktorëve u mbledh online në tre (3) mbledhje.

Struktura e revistës

Struktura e revistës “Jeta Juridike”, miratuar nga Bordi i Redaktorëve, vazhdon të jetë e njëjtë edhe për vitin akademik 2024-2025 me rubrikat si më poshtë:

Rubrika 1 - Artikuj teorikë.

Rubrika 2 – Opinione dhe debat juridik.

Rubrika 3 – Njohje me legjislacionin e ri.

Rubrika 4 – Njohje me praktikën gjyqësore.

Rubrika 5 – Njohje me përvojën ndërkombëtare teorike dhe praktike.

Rubrika 6 – Shkrime nga juristë të rinj.

Rubrika 7 – Aktivitete të Shkollës së Magjistraturës.

Rubrika 8 – Artikuj të spikatur “*Botime e artikuj të përkthyer nga periodikë të ndryshëm ndërkombëtarë*”.

Artikujt e rubrikave të mësipërme përkthehen të gjitha në anglisht.

Gjatë vitit akademik 2024 - 2025 është botuar nr. 2 dhe nr. 3 i vitit 2023 të revistës “Jeta Juridike” dhe janë në proces nr.1,2, viti 2024 Botimi i këtyre numrave për këtë vit akademik është financuar nga buxheti i shtetit.

Nr.	Titujt e botimeve	Nr. i kopjeve	Financimi	Gjendja
	Revista “Jeta Juridike” nr. 2 2023	300	Nga Buxheti	Është botuar
	Revista “Jeta Juridike” nr. 3 2023	300	Nga buxheti	Është botuar

Shkolla e Magjistraturës ka lidhur kontrata botimi me shtëpitë botuese⁵ sipas rregullave financiare e organizimit të procedurave të prokurimit publik dhe të vërë në dijeni autorin për këtë gjë. Tekstet botohen nga Shkolla e Magjistraturës kryesisht me fondet e saj që burojnë nga buxheti i shtetit, por edhe me mbështetje financiare të ofruara nga donatorë vendas dhe të huaj apo nga vetë autorët.



Shkolla e Magjistraturës i konsideron shpenzimet lidhur me revistën, si të domosdoshme për vazhdimësinë e një aktiviteti, që në të gjitha aspektet, përbën një arritje për institucionin si dhe një kontribut të rëndësishëm për doktrinën juridike të vendit tonë. Këtë vendim, strukturat drejtuese të Shkollës e morën duke u nisur nga komentet shumë pozitive për cilësinë dhe seriozitetin e revistës të nëpër takime të ndryshme me juristë nga i gjithë vendi. Veç kësaj, mjaft gjyqtarë, prokurorë e juristë të tjerë, madje pena të njohura të drejtësisë shqiptare, kontaktojnë vazhdimisht me redaksinë për të botuar artikujt e tyre. Kjo natyrisht flet për sukses cilësor të revistës dhe për pritjen e mirë të saj nga lexuesi. Por, nga ana tjetër, kjo e vendos

⁵ Shpenzimet e botimit i ngarkohen tërësisht ose pjesërisht Shkollës së Magjistraturës, sipas kushteve të parashikuara në kontratën e lidhur prej saj me autorin. Me raste përjashtimore teksti mund të botohet nga autori, kur ky i fundit e pranon këtë gjë.

redaksinë e revistës përpara një përgjegjësie të madhe që t'i përgjigjet edhe në kohë lexuesit që e pret me padurim daljen e revistës.

Mbetet një sfidë e rëndësishme për institucionin vazhdimi i botimit të saj në vitet në vazhdim me fondet e buxhetit të shtetit, ku parashikohet edhe shitja e saj dhe përdorimi i të ardhurave për botimin e numrave të ardhshëm të revistës. Janë në proces dhe numrat 2,3, viti 2024 i revistës “Jeta Juridike”, që për shkak të situatës së krijuar ka pasur një vonesë në botimin e tyre.

Numrat e revistës “Jeta Juridike”, për vitet 2024-2025, janë përgatitur me rreth 190 faqe (± 10 faqe) secila. Artikujt janë në gjuhën shqipe me abstrakt edhe në anglisht, botohet në një tirazh prej 300 kopjesh dhe kopertina pasqyron emblemen (logon) e Shkollës së Magjistraturës. Si përfitues të botimit shkencor “Jeta Juridike” janë identifikuar gjyqtarët dhe prokurorët në të gjithë vendin, pedagogët e Shkollës si dhe të fakulteteve të drejtësisë në vend, si dhe kandidatët që ndjekin programet e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës, pa lënë mënjanë edhe studentët e drejtësisë, avokatët, noterët, juristët e institucioneve dhe organizatave etj.



4.1.4 Botimi i Revistës “Magjistrati”

Pjesë e detyrimeve për përmbushjen e botimeve të Shkollës është botimi i revistës “Magjistrati” gjatë vitit akademik 2024 – 2025 janë në proces botimi revistat Magjistrati 18, 19 revistë e kandidatëve për magjistratë ky botim realizohet me memot e përgatitura e magjistratëve të vitit të dytë nga Moduli i Klinikës Ligjore.


Qëllimi i Klinikës Ligjore është t'i ofrojë Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe Prokurorisë së Përgjithshme këshillim ligjor pro bono në raste konkrete të komplikua, që kërkojnë kërkim ligjor krahasues dhe të thelluar. Kandidatët për magjistratë dhe prokurorë ndahen në grupe të vogla bazuar në temën dhe në institucionin për të cilin do të punojnë në të ardhmen. Produkti përfundimtar i Klinikës Ligjore janë Memorandumet Ligjore, të cilat i dërgohen institucionit që ka kërkuar këshillim në çështje konkrete.

Cilësia e Memorandumeve dhe e kërkimit ligjor që zhvillohet nga kandidatët për magjistratë garantohet nga drejtuesit akademikë, që janë një grup lektorësh të Shkollës së Magjistraturës si dhe ekspertë të jashtëm, me një eksperiencë të gjerë në çështjet ligjore për të cilat kërkohet


kërkim dhe këshillim ligjor. Puna e realizuar nga kandidatët për magistratë është një kontribut në cilësinë e argumentimit të institucioneve partnere në raste konkrete komplekse.

4.1.5 Botime tekstesh dhe librash

Gjate periudhes 2024 – 2025 shkolla e magistratures ka nxjere nga shtypi librin e prof. Ismet Elezi me titull: “Kultura Juridike në Shtet dhe shoqëri”



Si dhe librin e pedagogut të shkollës zotit Arben Isaraj.



4.1.6 Botimi i materialeve informuese dhe ndërgjegjësuere

Krahas botimeve monografike dhe revistës “Jeta Juridike” Shkolla e Magistraturës ka botuar materiale informuese dhe promovuese për aktivitete të shkollës, strategjinë e saj etj.

4.2 Puna kërkimore shkencore 2024-2025

Shkolla e Magjistraturës, gjatë vitit akademik 2024–2025, ka zgjeruar fushën e publikimeve. Me vendimin nr. 11, datë 16.3.2023, të Këshillit Drejtues, në Rregulloren e Botimeve të Teksteve Shkencore të Shkollës së Magjistraturës dhe të revistës “Jeta Juridike”, e cila përbën Aneksin 15 të “Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës të Republikës së Shqipërisë”, është bërë një shtesë e posaçme në nenin 4/1, ku parashikohet se:

Shkolla e Magjistraturës (SHM) boton në mënyrë periodike, çdo 3 muaj, përmbledhje të transkriptimeve të përmbajtjes së trajnimeve të zhvilluara në programin e formimit vazhdues, Përmbledhjet e transkriptimeve grupohen sipas fushave:

- E drejta kushtetuese dhe të drejtat e njeriut;
- E drejta administrative;
- E drejta penale (materiale dhe procedurale);
- E drejta civile (materiale dhe procedurale);
- Aftësi dhe kompetenca joligjore.

Për hartimin dhe përgatitjen e përmbledhjeve të transkriptimit sipas fushave të përmendura në pikën 2 të këtij neni, SHM-ja janë angazhuar kandidatë për magjistratë, që kanë përfunduar programin e vitit të dytë të formimit fillestar. Përzgjedhja e kandidatëve bazohet në renditjen e tyre në vlerësimin përfundimtar të vitit të dytë, duke filluar nga kandidati që është renditur i pari.

Gjatë këtij procesi, kandidatët për magjistratë udhëhiqen nga një grup pedagogësh/ekspertësh të fushave respektive.

Përfshirja e kandidatëve të përzgjedhur në këtë veprimtari të SHM-së shërben për të nxitur angazhimin e tyre në fushën e botimeve dhe në programin e formimit vazhdues pas diplomimit. Në përmbushje të këtij detyrimi, gjatë vitit akademik 2024-2025 është bërë e mundur përgatitja e buletineve nr.1, 2 , 3 të cilat janë publikuar në ëëbsiten e Shkollës së Magjistraturës.

Forumi i Shkollës së Magjistraturës

Shkolla prezantoi te magjistratët dhe kandidatët për magjistratë platformën e re për diskutim “Forumi Shkolla e Magjistraturës”. Pjesë e kësaj platforme u bënë një numër i kufizuar magjistratësh. Për shkak se ndërveprimi me magjistratët përmes kësaj hapësire, të krijuar nga Shkolla, përbën një risi, Departamenti i kërkimeve shkencore dhe botimeve, do të vijoj nga puna për promovimin e kësaj hapësira dhe rritjen e efektivitetit të saj.

4.3 Biblioteka

Biblioteka e Shkollës së Magjistraturës, edhe gjatë vitit akademik 2024–2025, ka vijuar të mbështesë aktivitetin mësimor, trajnues dhe kërkimor të shkollës, duke ofruar qasje të lirë në fondin e librave dhe atë të periodikëve që pasurojnë bibliotekën. Gjithashtu, përdoruesve u është mundësuar akses në fondin e materialeve digjitale të bibliotekës digjitale të shkollës, si dhe në platforma të tjera për kërkim informacioni, përfshirë katalogun elektronik dhe mjetin Cobiss Unpayëall për kërkimin e artikujve me qasje të hapur në tekst të plotë.


Gjatë këtij viti, fondi i bibliotekës është pasuruar me 14 tituj të rinj dhe gjithsej 24 njësi bibliotekare. Nga këto, 4 tituj në 14 njësi bibliotekare janë marrë si dhurime, ndërsa 10 tituj në 10 njësi bibliotekare janë blerë me fondet e parashikuara për zgjerimin e koleksionit. Librat e

blerë janë tituj në gjuhë të huaj, të botuar gjatë viteve 2023–2024 nga shtëpitë botuese Oxford University Press, Cambridge University Press, Giuffrè Lefebvre, Giappichelli Editore dhe Routledge Publishing.

Biblioteka digjitale ka vijuar të pasurohet me tituj të rinj. Ajo ofron qasje në tekst të plotë për libra, manuale, buletine dhe revista të botuara nga Shkolla e Magjistraturës, dhe aktualisht frekuentohet nga 250 përdorues të regjistruar. Pritet që numri i titujve dhe përdoruesve të saj të rritet më tej.

Gjatë vitit akademik, biblioteka ka ofruar informacion dhe udhëzime mbi përdorimin e teknikave të kërkimit në burime digjitale, si dhe në baza të dhënash bibliografike dhe shkencore, me qëllim përmirësimin e aftësive të hulumtimit dhe shfrytëzimit të burimeve të informacionit.

Përveç kësaj, biblioteka ka ofruar mjedise studimi dhe leximi në sallë. Përdoruesve u është mundësuar gjithashtu shfrytëzimi i pajisjeve teknike mbështetëse, si fotokopjuesi, laptopët dhe skaneri i librit.



Kreu 5

Zhvillimi i teknologjisë së informacionit 2024-2025

5. ZHVILLIMI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Shkolla e Magjistraturës, gjatë vitit akademik 2024–2025, në fushën e zhvillimit të teknologjisë dhe informacionit ka realizuar objektivat dhe veprimtarinë e përditshme në funksion të rritjes së efektivitetit në proceset akademike dhe administrative. Sfida për rritjen e efektivitetit ka bërë që shkolla t'i kushtojë vëmendje të veçantë Sektorit të Teknologjisë së Informacionit, i cili, në bashkëpunim me Sektorin e Formimit Fillestar dhe atë të Formimit Vazhdues, ka ndërmarrë masa konkrete për arritjen e objektivave.

Ky sektor ka siguruar pajisjet dhe mjetet elektronike të nevojshme për stafin akademik (të brendshëm dhe të jashtëm), stafin administrativ dhe studentët, duke garantuar vazhdimësinë e proceseve mësimore, kërkimore dhe administrative.

Gjatë këtij viti akademik, Sektori i Teknologjisë së Informacionit është përqendruar në disa drejtime kryesore në funksion të zhvillimit të teknologjisë:

5.1 Zhvillimi dhe përdorimi i platformës digjitale SMVSHM

Digjitalizimi i plotë i shërbimeve të Shkollës së Magjistraturës është dhe mbetet një nga objektivat kryesore të Sektorit të Teknologjisë së Informacionit. Platforma digjitale ofron një nivel të lartë automatizimi të proceseve të përditshme mësimore dhe një pjese të konsiderueshme të rrjedhës së punës brenda institucionit. Përdorimi i saj ka rritur efikasitetin e punës së kandidatëve të Programit të Formimit Fillestar, stafit pedagogjik dhe administrativ, si dhe pjesëmarrësve të programeve të SHM-së, përfshirë gjyqtarë, prokurorë, ndihmës ligjorë, kancelarë, këshilltarë dhe avokatë të shtetit. Njëkohësisht, ajo ka përmirësuar transparencën, raportimin statistikor dhe llogaridhënien.

Platforma ka lehtësuar gjithashtu aksesin e aplikantëve për t'u regjistruar në SHM, ku këtë vit akademik u regjistruan 459 aplikime për ndjekjen e programeve të saj.

Sistemi është përdorur në mënyrë funksionale edhe nga Këshilli i Lartë i Gjyqësorit dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë për vlerësimin e kandidatëve aplikues për pozicionet e gjyqtarëve, prokurorëve dhe ndihmësve ligjorë.

Gjatë këtij viti akademik, në bashkëpunim me stafin akademik dhe administrativ, janë analizuar të gjitha funksionet, nevojat dhe propozimet e lidhura me përfundimin e zhvillimit të platformës digjitale. Bazuar edhe në rekomandimet e Shkollës Italiane të Magjistraturës, kanë filluar të hartohen planet për fazat e mëtejshme të zhvillimit të sistemit. Këto plane parashikojnë funksionalitete të reja për mbështetjen më të mirë të magjistratëve dhe kandidatëve, përmirësim të kapaciteteve të kërkimit dhe rritje të përdorshmërisë së sistemit në pajisje mobile dhe tabletë.

5.2 Implementimi i shërbimit Microsoft 365

Në Shkollën e Magjistraturës gjatë këtij viti akademik u implementua me sukses Microsoft 365 në të gjithë sistemin kompjuterik duke përfutur nga ofertat arsimore të Microsoft. Në të gjithë

pajisjet e Shkollës por dhe në pajisjet personale të studentëve apo magistratëve mund të aktivizohen produktet Word, Excel, PowerPoint, Outlook, Teams.

U siguruan 40 licenca për stafin administrativ dhe akademik, si dhe 1600 licenca falas për studentët. Kjo ka përmirësuar ndjeshëm bashkëpunimin, ka zgjidhur sfidat e licensimit, ka përmirësuar besueshmërinë e e-mail-it dhe ka prezantuar shërbime në bazë të cloud-it për teknologjinë e informacionit. Procesi u shtri në kohë për shkak të trajnimit të vazhdueshëm të përdoruesve që sapo ishin prezantuar me këtë zhvillim teknologjik. Gjithashtu në mbështetje të këtij procesi u pa e nevojshme edhe zëvendësimi i shumë pajisjeve kompjuterike që nuk e suportonin dot këtë zhvillim teknologjik. Për këtë qëllim është konceptuar dhe parashikuar zëvendësimi i këtyre pajisjeve deri në fund të vitit në vazhdim.

Microsoft Azure është platforma e shërbimeve cloud e Microsoft-it. Ajo ofron një gamë të gjerë shërbimesh duke ofruar siguri të fortë dhe shkallëzim. Në bashkëpunim me partnerët tanë të Shkollës Italiane të Magjistraturës janë ofruar udhëzime të vlefshme për zgjedhjen e shërbimeve më të përshtatshme të Azure për Shkollën e Magjistraturës. Ngritja e infrastrukturës kompjuterike në Cloud është konceptuar dhe parashikuar të kryhet sa më shpejt për ti paraprirë masave edhe për zhvillimet që priten në fushën e sigurisë kibernetike.

5.3 Digjitalizimi i mësimdhënies

Shkolla e Magjistraturës vijon të integrojë në mënyrë të plotë teknologjinë me qëllim lehtësimin dhe modernizimin e procesit të mësimdhënies në mjediset dhe sallat e mësimi. Përveç procesit thelbësor të implementimit të platformës Microsoft 365, një vend të rëndësishëm zë edhe përdorimi në shkallë të gjerë i pajisjeve teknologjike.

Me ndryshimet e reja në procesin akademik për sektorët e Formimit Fillestar dhe Formimit Vazhdues, si dhe me synimin për përmirësimin e procedurës së zhvillimit të provimeve, Shkolla ka mundur realizimin e provimeve nëpërmjet përdorimit të laptopëve dhe programeve të monitorimit (OBS) për të gjithë kandidatët e Formimit Fillestar. Kjo ka garantuar zhvillimin normal, cilësor dhe komod të provimeve, proces i cili do të vijojë edhe në vitet e ardhshme akademike.

Paralelisht, janë ndërmarrë masa për zëvendësimin e sistemit të regjistrimit në sallën e gjyqit imitues, proces i cili pritet të përfundojë në fillim të vitit të ri akademik. Përveç instalimit të paneleve interaktive dhe Smart TV-ve në sallat e mësimi dhe trajnimit, Shkolla ka shtuar numrin e laptopëve, duke siguruar nga një pajisje për çdo anëtar të stafit akademik dhe për kandidatët. Pajisja me teknologji të nevojshme (kompjuterë, printerë, akses interneti etj.) ka ndikuar dukshëm në rritjen e cilësisë së mësimdhënies nga pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm, trajnuesit, ekspertët dhe lehtësuesit.

Për pjesëmarrësit që nuk kanë mundësi të jenë fizikisht të pranishëm në aktivitete apo mbledhje, Shkolla ka siguruar zhvillimin e sesioneve në formë online përmes platformës Microsoft Teams. Kjo platformë, përveç mundësive të komunikimit në distancë, ofron lehtësira të shumta për stafin akademik, trajnuesit dhe kandidatët, si:

- shkëmbimi i materialeve mësimore, ideve dhe diskutimeve individuale apo në grup;
- organizimi i kalendarëve personalë dhe kolektivë,
- ruajtja e materialeve në OneDrive,
- publikimi i orareve të trajnimeve dhe organizimeve të ndryshme;

- realizimi i thirrjeve telefonike dhe video-konferencave.

5.4 Faqja web, mjete zyrtar i informimit

<https://www.magjistratura.edu.al/>

Faqja zyrtare e internetit e Shkollës së Magjistraturës gjatë gjithë vitit pasqyroj në kohë reale aktivitetet e ndryshme të zhvilluara në kuadër të Formimit Vazhdues për gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë. Ajo publikoi gjithashtu, në mënyrë të menjëhershme dhe të përditësuar, njoftimet e rëndësishme që lidhen me proceset kryesore institucionale, si njoftimet mbi konkursin e provimit të pranimit, shpalljet e fituesve, njoftimet e rekrutimit dhe komunikime të tjera me interes të gjerë.

Informacionet e përditësuara në faqen *web*, si ato që lidhen me programin e transparencës, kanë shërbyer jo vetëm për publikun e brendshëm, por kanë ofruar të dhëna të vlefshme edhe për institucione të tjera, përfshirë Komisionerin për të Drejtën e Informimit. Po ashtu, faqja ka vijuar të publikojë informacion rreth trajnimeve ndërkombëtare dhe aktiviteteve të tjera të rëndësishme.

Në funksion të përmirësimit të aksesit, në faqen web është integruar platforma digjitale SMVSHM, e cila tashmë mund të aksesohet në mënyrë më të thjeshtë dhe më të shpejtë. Gjithashtu janë integruar forumi elektronik, lojërat dhe kuicet interaktive, duke e bërë faqen më funksionale dhe më të aksesueshme për përdoruesit.


5.5 Komunikimi dhe transparenca nëpërmjet rrjeteve sociale



Shkolla e Magjistraturës, me qëllim rritjen e vizibilitetit të aktiviteteve të saj, dhe jo vetëm për të pasqyruar aktivitetet e Shkollës në funksion të parimit të transparencës dhe informimit, por edhe për të rritur interesin dhe për të forcuar besimin e publikut për Shkollën e Magjistraturës

dhe gjithashtu duke marrë në konsideratë se, një pjesë e madhe e përdoruesve janë të një grupmoshe të re, ka dhe profilin e saj në rrjetin “Facebook”, me adresë https://www.facebook.com/Shkolla_e_magjistratures, ku pasqyron aktivitetet më të rëndësishme ditore dhe njoftimet në kohë reale, si në figurën më poshtë:

Por gjatë vitit akademik u vu re dhe një interaktivitet i lartë ndërveprimi ndërmjet shkollës dhe personave të interesuar rreth saj, nëpërmjet postimeve të aktiviteteve të shumta që shkolla zhvilloi gjatë këtij viti akademik. Më poshtë paraqitet profili/faqa e Shkollës së Magjistraturës në LinkedIn ku pasqyrohen aktivitetet e ndryshme të përditshmërisë. Linku për të aksesuar profilin është: <https://ëëë.linkedin.com/in/shkolla-e-magjistratures-7a98b9223/>



5.6 Komunikimi nëpërmjet Forumit të Shkollës së Magjistraturës

Forumi profesional, me pjesëmarrje të magjistratëve, këshilltarëve/ndihmësve ligjorë, avokatëve të shtetit, kancelarëve dhe subjekteve të tjera përfituese të programeve në Shkollë, apo persona të tjerë të interesuar të sistemit të drejtësisë në vend shërben si hapësirë diskutimi për çështje të ndryshme të së drejtës.

Veçantia e forumit, si një hapësirë miqësore në përdorim është që lejon një gjuhë sa profesionale aq edhe të thjeshtë për dhënien e mendimeve, duke mundësuar akses në çdo moment të ditës pa qenë shumë impenjative për përdoruesin. Këto shihen si pika të forta në efektivitetin e këtij mjeti pedagogjik-praktik.

5.7 Teknologjia e informacionit në funksion të sigurisë

Teknologjia e informacionit (TI) luajti edhe këtë një rol kyç në forcimin e sigurisë në shkollën e magjistraturës. Disa prej mënyrave se si ndihmoi paraqiten më poshtë:

1. Menaxhimi i të dhënave

Ruajtja e Sigurt: Sistemet e TI ofruan mënyra të sigurta për ruajtjen dhe menaxhimin e të dhënave të ndjeshme të kandidatëve dhe stafit.

Kontrolli i Aksesit: Politikat e aksesimit ndihmuan në kufizimin e informacionit vetëm për ata që kanë nevojë për të.

2. Monitorimi dhe mbikëqyrja

Sistemet e monitorimit: Softuerët për monitorimin e rrjeteve ndihmuan në identifikimin e aktiviteteve të dyshimta ose të paautorizuara, gjatë procesit mësimor dhe të periudhës së provimeve.

3. Edukimi dhe Trajnimi

Trajnimet për Sigurinë Kibernetike: Programet e trajnimit ndihmuan kandidatët dhe stafin të kuptojnë rreziqet dhe praktikat më të mira për mbrojtjen e informacionit.

4. Mjetet e Sigurisë

Antivirus dhe Fireëall: Përdorimi i mjeteve të sigurisë ndihmuan në mbrojtjen e sistemeve nga sulmet kibernetike.

5. Marrëdhëniet me palët e tjera

Partneritetet: Bashkëpunimi me institucionet e tjera si QTI, KLGJ, AKSK etj. për të siguruar mbështetje dhe resurse të nevojshme.

Njoftimi i Palëve të Interesit: Komunikimi i rregullt me stafin administrativ, stafin pedagogjik dhe kandidatët për masat e sigurisë.

6. Vlerësimi dhe përmirësimi

Analiza e Metrikave: Monitorimi i performancës së sistemeve dhe faqes ëeb dhe rrjeteve sociale ndihmoi në identifikimin e dobësive dhe përmirësimin e politikave.

Rishikimi i Politikave: Politikat e sigurisë u rishikuan edhe këtë vit për t'u përshtatur me ndryshimet dhe investime të reja në teknologji dhe rreziqe.

PJESA E DYTË

Prioritetet e Shkollës për vitin e ri akademik 2025-2026

2. PRIORITETET E SHKOLLËS PËR VITIN E RI AKADEMIK 2025-2026

2.1 PËR PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR

Së pari, prioritet i Shkollës do të vijojë të jetë *zhvillimi me standarde të larta i procesit mësimor, rishikimi i Programit të Formimit Fillestar në tërësi dhe rishikimi i kurikulave të lëndëve në funksion të rritjes së përshtatshmërisë së programit me punën që do të bëjnë magjistratët dhe subjektet e tjera të trajnimit menjëherë pas emërimit*. Ky prioritet do të realizohet duke pasur në vëmendje objektivat specifike, si më poshtë:

1. Programi i trajnimit tre-vjeçar për vitin e ardhshëm akademik, 2025-2026, do të shoqërohet me kurikula të standardeve bashkëkohore, në përshtatje me nevojën e kandidatit në momentin që do të nisë rolin e tij si gjyqtar apo prokuror i sistemit. Këto kurikula do të konceptohen në formën e moduleve të strukturuar, sipas një programi të riparë në mënyrë tërësore; Projektideja për ndryshim të lëndëve bazë sipas një strukture lënde që do të ndjek strukturën e gjykimit, është vlerësuar edhe nga shkolla holandeze, si shkolla përgjegjëse për përmirësimin e programit të formimit fillestar, si një qasje inovatore dhe shumë e përshtatshme që përmirëson në mënyrë thelbësore programin e formimit fillestar dhe e shndërron atë në një program bazuar në praktikë;
2. Vlerësimi i kandidatëve do t'i përshtatet mënyrës së re të konceptimit të kurikulave dhe do të synojë vlerësimin e aftësive dhe kompetencave të fituara nga ana e tyre, jo vetëm atyre ligjore, por edhe aftësive të tjera jo-ligjore “soft skills”;
3. Kurikulat do të vijojnë të përfshijnë praktikë dhe çështje të trajtuara nga ligji i BE-së dhe praktika ndërkombëtare, në mënyrë që kandidatët për magjistratë të jenë në gjendje ta përdorin ligjin e BE-së apo atë ndërkombëtar në çdo rast që do t'iu paraqitet në punën e tyre;
4. Çështje të etikës, integritetit, sjelljes dhe aftësive të tjera “soft skills” janë pjesë e rëndësishme e objektivave mësimore dhe trajtimi i tyre do të bëhet pjesë integrale e kurikulave, përmes rasteve praktike;
5. Roli i shkollës në vlerësimin e zbatimit të ndryshimeve të programit do të jetë aktiv dhe do të synojë identifikimin në kohë të çështjeve që kanë nevojë për përmirësim;
6. Përmirësimi i praktikave për realizimin e provimit përfundimtar të vitit të dytë, i cili zhvillohet në përfundim të ciklit teorik dhe praktik-teorik të studimeve, për ta bërë vlerësimin përfundimtar, sa më të dobishëm dhe në funksion të klasifikimit të kandidatëve. Duhet theksuar rëndësia e këtij provimi në vlerësimin përfundimtar nga ana e Këshillit Pedagogjik, të kandidatëve për magjistratë, pas përfundimit të vitit të dytë;
7. Viti i dytë i Programit të Formimit Fillestar do të rishikohet në mënyrë që ai të krijojë një lidhje më organike me vitin e parë dhe të aftësojë kandidatët në një nivel më të lartë se ai i kërkuar për vitin e parë; mendimi kritik dhe hartimi i akteve është pjesë esenciale e programit dhe e vlerësimit;
8. Bashkëpunimi me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë për praktikën profesionale të vitit të tretë me qëllim harmonizimin e kërkesave të këtij viti dhe vlerësimit të tij me dy vitet e para të realizuara dhe vlerësuara nga SHM-ja. Shkolla do të vlerësojë mundësinë e përmirësimit të kontakteve me magjistratët udhëheqës të praktikës profesionale. Shkolla do të vlerësojë edhe mendimin e kandidatëve për magjistratë, pas

plotësimi të pyetësorëve nga ana e tyre për magistratët e tyre udhëheqës. Pyetësorët e vlerësimit për magistratin udhëheqës nga kandidati për magistrat do të plotësohen gjatë periudhës së praktikës. Në përfundim të vitit akademik, Këshilli Pedagogjik do të hartojë një propozim më të plotë për vlerësimin e cilësisë së veprimtarisë dhe programin e udhëheqësve, si dhe do të kryejë një vlerësim të performancës së praktikës profesionale, duke bërë një pasqyrim të gjithë situatës, performancës së secilit kandidat, si dhe punën e kryer nga secili prej magistratëve udhëheqës;

9. Hartimi i një programi të përshtatshëm për ndjekjen e trajnimeve sipas Programit të Formimit Vazhdues nga kandidatët e vitit të tretë të Shkollës, jo vetëm kundrejt zgjedhjes së temave të seminareve prej tyre, por edhe përzgjedhjes së temave të detyrueshme për t'u ndjekur nga Shkolla, meqenëse viti i tyre i praktikës aktive është jo vetëm një vit prove përshtatshmërie direkte me profesionin, por edhe një vit formimi;

10. Hartimi dhe realizimi i një programi të posaçëm për gjyqtarët dhe prokurorët për të cilët organet e rivlerësimit do të vendosin ndjekjen e një kursi trajnimi në Shkollë, që i përgjigjet eksperiencës, përgatitjes dhe boshllëqeve që ata kanë;

11. Hartimi dhe realizimi i një programi të mëvetshëm për ndihmësit dhe këshilltarët ligjorë, i fokusuar në kërkesat e profesionit;

12. Organizimi i një programi tremujor për kandidatët për kancelarë si pjesë e Programit të Formimit Fillestar të tyre.

Së dyti, Shkolla do të vijojë të angazhohet maksimalisht në kërkesën për ***standarde të larta në përzgjedhjen e stafit pedagogjik***. Ky rezultat vjen si përmbushje e disa objektivave:

1. Rekrutimi i stafit pedagogjik bazuar në meritë dhe me transparencë të plotë nga ana e Shkollës, duke respektuar kriteret dhe rregullat e përcaktuara në ligj dhe në Rregulloren e Brendshme të Shkollës, si dhe trajnimi i tyre. Këtu kemi parasysh hartimin e një programi për trajnim trajnerësh për trajnerët ekzistues dhe për çdo trajner të ri, që futet rishtazi në Shkollë, para se të fillojë nga puna, me qëllim unifikimin e metodave të mësimdhënies, duke ruajtur parimet e pavarësisë akademike. Gjithashtu, do të parashikohen trajnime të veçanta për gjyqtarët dhe prokurorët udhëheqës të praktikës profesionale të kandidatëve. Një prioritet lidhur me stafin akademik do të jetë edhe krijimi i mundësive për përfshirje të profesorëve/lektorëve ndërkombëtarë në Programin e Formimit Fillestar;

2. Rritja e efikasitetit të sistemit të vlerësimit të Formimit Fillestar nga vetë kandidatët për magistratë. Sistemi i vlerësimit të Formimit Fillestar, ku kryesisht kandidatët për magistratë shprehen anonimisht për nivelin e organizimit të procesit mësimor, duke filluar nga programet, struktura e tyre, tematika, metodologjia, pedagogët dhe specialistët, me qëllim që të pasqyrohen ndryshimet për vitet e ardhshme akademike. Për të rritur shkallën e profesionalizmit në mësimdhënie, duhet të bëhet kujdes në zbatimin e sistemit të vlerësimit të pedagogëve, për të parë nëse ka nevojë për ndryshime në listën e tyre, si dhe në grupet e lëndëve, të parashikuara në programet mësimore. Procesi i vlerësimit të pedagogëve të Formimit Fillestar realizohet në fund të çdo viti akademik dhe kryhet fillimisht nga kandidatët për magistratë, të cilët plotësojnë pyetësorët në fund të çdo viti akademik, duke respektuar anonimin. Përgjegjësi i Formimit Fillestar përgatit një relacion me shkrim në fund të çdo viti akademik me vlerësimet për punën e çdo pedagogu/specialisti të aktivizuar gjatë vitit akademik të cilin ia drejton Drejtorit të Shkollës. Drejtori i Shkollës, çdo fillim viti akademik përgatit një raport për

Këshillin Drejtues mbi rezultatet e vlerësimit të pedagogëve/specialistëve gjatë vitit pararendës akademik, së bashku me propozimet për marrjen e masave për largimin apo ndryshimin e atyre që nuk plotësojnë kriteret, me qëllim që Këshilli Drejtues të realizojë vendimmarrjen e tij në formën e dhënies së *Vlerësimit Përfundimtar*. Ky proces do të detajohet dhe përmirësohet në mënyrë që të ofrojë një mekanizëm efektiv që jo vetëm pasqyron cilësinë e ekspertizës, por edhe shërben për të motivuar magistratët për të marrë më shumë angazhim në Shkollë si trajnues.

Së treti,-prioritet për vitin e ri akademik 2024-2025 do të vijojë të jetë përmirësimi i ***provimit të pranimit*** për rekrutimin e magistratëve, këshilltarëve e ndihmësve ligjorë dhe kancelarëve në gjykata e prokurori, prioritet i cili synon të ofrojë të gjitha garancitë për të qenë transparent, i pavarur, i bazuar në meritë dhe i ankimueshëm, sipas ligjit. Ky proces përmirësimi, i cili po lehtësohet nga ekspertiza e çmuar e shkollës franceze, si shkolla përgjegjëse për përmirësimin e provimit të pranimit në kuadër të projektit të binjakëzimit, do të ketë në fokus mundësinë për të pasur ndryshime në ligj dhe/ose ndryshime në Rregullore dhe aktet që rregullojnë rekrutimin në shkollë. Përmirësimi synon veçanërisht fazën e parë të provimit, testin scantron, dhe fazën e fundit të provimit, testin e shëndetit mendor dhe psikologjik me qëllimin për ta bërë këtë fazë të efektshme.

Së fundmi, Shkolla konsideron të rëndësishëm ***forcimin e marrëdhënieve me organet e tjera të qeverisjes së sistemit të drejtësisë*** si rrjedhojë e detyrimeve dhe interesit të përbashkët për forcimin e kapaciteteve të sistemit të drejtësisë. Për përmbushjen e këtij rezultati do të synohet:

1. bashkëpunimi dhe konsultimi lidhur me vendet vakante dhe nevojat e gjyqësorit dhe prokurorisë për gjyqtarë e prokurorë të rinj, për të parë se si do të riorganizohen gjykatat/prokuroritë dhe strukturat e tyre;
2. bashkëpunimi për verifikimin në kohë nga ana e Shkollës e plotësimit të kriterëve për konkurrentët dhe e verifikimit të pastërtisë së pasurisë dhe figurës nga ana e këshillave;
3. këshillimin për analizimin e nevojave dhe drejtimeve që organet e qeverisjes do të konsiderojnë të përshtatshme për t'u përfshirë në programin e formimit fillestar në Shkollë.

2.2 Për Programin e Formimit Vazhdues

Viti akademik 2025-2026 do të jetë një vit intensiv përse i takon vlerësimit cilësor të aktiviteteve trajnuese, rishikimit të metodologjisë dhe planifikimit të një programi trajnimi të specializuar dhe të ndarë në kohë.

Programi i Formimit Vazhdues do të orientohet drejt temave më të rëndësishme për të cilat kërkesat e magistratëve kanë qenë të larta dhe do të përshtatet me nevojën për trajnim të magistratëve të rinj në sistem, por edhe me nevojat që burojnë nga zhvillimi i karrierës në gjyqësor dhe prokurori.

Së pari, prioriteti kryesor i Shkollës do të jetë cilësia e ofrimit të trajnimeve dhe vlerësimi i trajnimeve, si nga këndvështrimi i ekspertëve, ashtu edhe i pjesëmarrësve. Për të arritur këto rezultate, Shkolla ka vendosur disa objektiva.

1. Hartimin e një Programi të Formimit Vazhdues që mbështet nevojat për trajnim të sistemit gjyqësor në të gjitha nivelet dhe vlerëson çështje të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare në zhvillimin e së drejtës.
2. Rishikimin e metodologjisë dhe analizës së nevojave për trajnim bazuar në standardet ndërkombëtare, me asistencën edhe të shkollës italiane, duke reflektuar analizën e nevojave për trajnim të magjistratëve të rinj, nevojën për specializim të magjistratëve sipas fushave të caktuara dhe karrierës që kanë në gjyqësor apo prokurori dhe nevojën për trajnim të kategorive të tjera, si ndihmësit ligjorë, avokatët e shtetit, inspektorët e ILD-së, kancelarët e gjykatave/prokurorive, etj.;
3. Vlerësim expost për ecurinë e cikleve të specializuara të trajnimeve me synim analizën e nevojës për vijimësinë e tyre. Forcimi i rolit të koordinatërove të moduleve të trajnimit do të trajtohet me prioritet me qëllim ndërveprimin mes ekspertëve dhe “korigjimin” apo plotësimin e temave të moduleve sipas nevojave;
4. Bashkëpunimin mbi baza periodike me KLGJ/KLP-në, këshillat e gjykatave, magjistratët në sistem, subjektet e tjera përfutuese të trajnimit dhe organe të tjera të përfshira në procesin e analizës së nevojave për trajnim, bazuar në ligj, Rregullore dhe marrëveshje dypalëshe (nëse është rasti);
5. Organizimin e trajnimeve rajonale në bashkëpunim të ngushtë me gjykatat/prokuroritë “pritëse”.
6. Ndjekjen e një metodologji interaktive, bazuar në kompetencat dhe aftësitë e subjektit të trajnimit dhe të përputhur me standardet ndërkombëtare, në realizimin e aktiviteteve trajnuese;
7. Realizimin e vlerësimeve afatshkurtra dhe afatgjata të ndikimit të trajnimit bazuar në një metodologji të standardizuar (standardet e EJTN-së) për procesin e vlerësimit të impaktit të trajnimit në punën e magjistratëve;
8. Përzgjedhjen e trajnerëve mbi bazë merite dhe në transparencë të plotë, duke i dhënë përparësi rritjes së përfshirjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve, si edhe ndjekjes me kujdes të procesit për përgatitjen e kurikulave dhe të moduleve të trajnimit prej trajnuesve. Rekrutimi i trajnerëve të rinj dhe trajnimi i trajnerëve jo të përhershëm, si dhe zhvillimi i kurikulave dhe udhëzuesve për mentorët dhe trajnerët, duke përfshirë rolet, përgjegjësitë dhe metodologjitë e vlerësimit, do jenë disa nga mënyrat për të realizuar këtë objektiv.
9. Rishikimi i kriterëve për zgjerimin dhe larmishmërinë e bazës së ekspertëve me qëllim përfshirjen e profileve multidisiplinare dhe përmirësim të cilësisë së trajnimeve, zgjerim të bazës së ekspertëve, përmirësim të diversitetit dhe profesionalizmit.
10. Harmonizimi i metodologjive midis trajnimit fillestar dhe atij të vazhdueshëm. Zhvillimi i një manuali të harmonizuar dhe të qëndrueshëm për trajnerët e Shkollës së Magjistraturës, i cili synon koherencë midis trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm dhe përafrim me standardet e BE-së, ku të përfshihet: metodologjia pedagogjike, dizajni i leksioneve, vlerësimi i njohurive dhe soft-skills.
11. Përshtatjen e kalendarit të aktiviteteve trajnuese në rastet e ndryshimeve të rëndësishme në legjislacion me qëllim diskutimin dhe interpretimin e tyre mes profesionistëve të së drejtës;
12. Trajnimin e magjistratëve shqiptarë mbi ligjin dhe standardet e BE-së dhe praktikën ndërkombëtare dhe trajnimin e trajnerëve në këtë fushë me qëllim krijimin e një bërthame

ekspertize që do të ruajë qëndrueshmërinë dhe cilësinë e trajnimeve në fusha të ndryshme ku ligji i BE do të ketë ndikim shumë të afërt;

13. Zhvillimi dhe testimi i moduleve të trajnimit online për magjistratët me qëllim fleksibilitet të trajnimit dhe forcim të kapaciteteve të ShM për e-learning, duke krijuar një kornizë dixhitale trajnimi që mund të zgjerohet në mënyrë të qëndrueshme.

14. Identifikimin e nevojave për kurse të reja në fusha të tjera paralelisht me kurset ekzistuese për të rritur aftësitë gjyqësore mbi efektet e faktorëve shoqërorë në rritjen e përgjegjësisë sociale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, për shembull, në fushën e logjikës, qëndrimit dhe sjelljes, dhe psikologjisë gjyqësore e të tjera.

Së dyti, për shkak të ngarkesës dhe përgjegjësisë së madhe që ka Sektori i Formimit Vazhdues në Shkollë, prioritet i Shkollës do të jetë forcimi i kapaciteteve administrative dhe maksimizimi i përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe platformave në dispozicion, në funksion të mbledhjes dhe menaxhimit të të dhënave, ruajtjes së tyre, shpërndarjes së materialeve dhe komunikimit me subjektet e këtij programi. Objektivat në mbështetje të këtij rezultati janë:

1. Përmirësimi i sistemit të mbajtjes së të dhënave lidhur me aspekte të ndryshme të komponentëve të Formimit Vazhdues, të tilla, si: listat e pjesëmarrësve, ditët e trajnimit mbi baza vjetore dhe 5-vjeçare, tematika, certifikimi, aplikimi *on line* etj.;

2. Përmirësimi i aspekteve të koordinimit të aktiviteteve trajnuese dhe zyrtarizimit të protokolleve dhe mënyrave të njoftimit të pjesëmarrësve nga ana e Shkollës dhe e konfirmimit të pjesëmarrjes ose mospjesëmarrjes, përmes sistemit të ri elektronik të krijuar në Shkollë;

3. Zhvillimi i komunikimit me gjyqtarët dhe prokurorët nëpërmjet përdorimit të teknologjisë ekzistuese dhe në zhvillim.

Shkolla ka faqen e saj të internetit, në të cilën do të paraqiten informacione të ndryshme. Do të jemi vazhdimisht të përditësuar me ndryshimet në teknologji dhe do të kërkojmë që të përfitojmë plotësisht nga burimet e disponueshme të internetit. Ndër të tjera, kjo do të përfshijë zhvillimin e mëtejshëm të faqes së internetit në përfitim të gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë, duke zhvilluar dhe stimuluar përdorimin e forumit të diskutimit në internet dhe përhapjen e informacionit ligjor me anë të komunikimit online me ta. Ne do të vazhdojmë t'i kushtojmë vëmendje përmirësimit të faqes së internetit të Shkollës për ta bërë sa më të dobishme që të mundemi, midis të tjerave duke: hedhur informacion në lidhje me kurset e ardhshme, në mënyrë që të rritet pjesëmarrja; me hedhjen e materialeve ligjore, si leksione jurisprudence të mbledhura nga seminarët, në mënyrë që njohuritë e trajnimit të përhapen në të gjithë vendin;

4. Përdorimi i sistemit të ri të teknologjisë së informacionit SMVSHM në lidhje me aplikimin apo edhe disponimin e materialeve trajnuese, ku çdo gjyqtar apo prokuror, të ketë mundësinë e pasjes së të gjitha materialeve trajnuese të përdorura nga ekspertët në aktivitetet përkatëse, por edhe të kontrollojë temat për të cilat ka interes; Shkolla do të synojë heqjen e letrës së printuar nga çdo komunikim mes përfituesve të trajnimit;

5. Bashkëpunimi më i ngushtë me Këshillat dhe organe të tjera të larta të drejtësisë në vend me qëllim këshillimin, shkëmbimin e ideve dhe nxitjen e rritjes profesionale përmes trajnimit.

2.3 Për projektet dhe marrëdhëniet me jashtë

Procesi i negociatave për anëtarësim në BE do të vijojë të ndikojë në harmonizimin e akteve dhe aktiviteteve të Shkollës me standardet e kërkuara. Projektet dhe marrëdhëniet me partnerët ndërkombëtarë kanë një rol të vecantë në përmbushjen e standardeve më të larta të cilësisë në “ofertën” e trajnimit në Shkollë. Për këto arsye do të vijoj të jetë prioritet:

1. Realizimi i shkëmbimeve dhe bashkëpunimit me qëllim përmbushjen e detyrimeve të Shkollës së Magjistraturës në kuadër të planit të veprimit të integritetit të Shqipërisë në BE.

1. Vijimi i përfaqësimit dinjitoz të kandidatëve tanë për magistratë në Konkursin Ndërkombëtar THEMIS, ku Shkolla në vijimësi ka fituar pozicione të vlerësuara nga juritë e konkursit.

2. Mundësimi i pjesëmarrjes së pedagogëve, ekspertëve, trajnerëve, gjyqtarëve, prokurorëve në aktivitetet trajnuese të institucioneve të ndryshme të trajnimit gjyqësor të BE-së sipas fushave të interesit.

3. Pjesëmarrje e vazhdueshme e kandidatëve për magistratë në programet e shkëmbimit dhe aktivitetet ndërkombëtare gjyqësore të organizuara nga akademitë e ndryshme gjyqësore në Evropë.

4. Akomodimi dhe harmonizimi i kërkesave për bashkëpunim që vijnë nga donatorë të ndryshëm pa ceduar nga prioritetet e drejtimeve kryesore të proceseve akademike, administrative dhe institucionale të Shkollës, me synimin për të përfituar maksimalisht nga interesi për bashkëpunim i partnerëve ndërkombëtarë.

5. Rritja e kapaciteteve profesionale të punonjësve të Sektorit të Formimit Fillestar dhe Vazhdues në zbatimin e projekteve të ndryshme të bashkëpunimit me donatorët.

2.4 Publikimet dhe puna kërkimore shkencore

Kërkimi shkencor dhe publikimi mbeten pika kyçe të veprimtarisë dhe prioriteteve të Shkollës. Gjatë vitit të ardhshëm akademik ky program do të fokusohet në:

1. Angazhimin në veprimtari studimi dhe kërkimi në fusha prioritare të së drejtës për të nxjerrë produkte shkencore dhe informuese në funksion të aktorëve të sistemit të drejtësisë.

2. Lehtësimin dhe nxitjen e bashkëpunimit të magistratëve dhe subjekteve të tjerë pjesë e veprimtarisë së saj, por edhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm të sistemit të drejtësisë në vend dhe ndërkombëtarisht, me anë të metodave teknologjike dhe inovatore të komunikimit dhe ofrimit të shërbimeve

3. Orientimin drejt kërkesave të tashme dhe të ardhshme që lidhen me procesin e integritetit në BE.

Për realizimin e këtyre objektivave do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për:

- a) Përdorimin e moduleve e-learning të prodhuara në Europë ose të krijuara në Shkollë dhe shkëmbimin e burimeve (dokumente, botime shkencore, kurikula trajnimi dhe çdo “mjet trajnimi” tjetër, të cilat do të mund të kontribuojë në përmirësimin e njohurive dhe dijeve të sistemeve gjyqësore dhe juridike përkatëse) me shkollat homologe dhe partnerët kombëtarë/ndërkombëtarë;

- b) Përfshirjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve në fushën e publikimeve dhe forcimin e punës kërkimore e shkencore për përgatitjen e revistës “Jeta Juridike”.
- c) Botimin nën emrin dhe kujdesin e Shkollës së Magjistraturës të teksteve dhe librave të cilët trajtojnë probleme ligjore të lidhura ngushtë me programet e lëndëve dhe kurseve të Trajnimit Fillestar e Vazhdues të gjyqtarëve e prokurorëve, duke synuar në unifikimin dhe analizimin e praktikës gjyqësore e juridike kombëtare dhe ndërkombëtare. Botimi i teksteve dhe librave shkencorë do të bëhet duke vijuar me procedurën e miratimit të tyre në Bordin e Redaktorëve dhe me dy recenca. Tekstet me karakter publicistik, historik dhe tërësisht teorik, të pailustruara me praktikë gjyqësore nuk janë në objektin dhe qëllimin e botimeve të Shkollës.
- d) Botimin, në mënyrë periodike, përmbledhje të transkriptimeve të përmbajtjes së trajnimeve të zhvilluara në Programin e Formimit Vazhdues;
- e) Rishikimin e teksteve ligjore ekzistuese dhe bërjen e një plani për botimin e leksioneve, manualeve, përgatitjen e teksteve më thelbësore që mungojnë, përditësimin e atyre që ekzistojnë dhe krijimin e një liste të teksteve të huaja që konsiderohen të dobishme.
- f) Botimin e librave me praktikë gjyqësore (*Case study*) për Trajnimin Fillestar.
- g) Forcimin ekspertizës së saj me ekspertë të huaj në tema që lidhen me BE-në dhe E drejta e BE-së do të jetë pjesë integrale e planeve dhe programeve mësimore të formimit fillestar dhe Programit të Formimit Vazhdues.
- h) Krijimin e mundësisë për shkëmbimin e mendimeve dhe përmbledh diskutimet e realizuara në Forumin e Shkollës së Magjistraturës dhe në platforma të tjera.
- i) Zhvillimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të bibliotekës, e cila është thelbësore për magjistratët që kryejnë Formimin Fillestar dhe Vazhdues, si edhe qenien e një burimi për të diplomuarit (në rastin tonë për gjyqtarët dhe prokurorët) dhe të interesuarit e tjerë.
- j) Përgatitjen e librave, manualeve, kurseve dhe moduleve për lëndë apo tema që trajtohen në procesin e Formimit Fillestar të magjistratëve. Motivimin dhe trajnimin e kandidatëve për magjistratë për të hulumtuar dhe shkruar ese e tema me qëllim botimin e punimeve më të mira ose të pjesëve të tyre.
- k) Përmirësimin në vazhdimësi të punës kërkimore-shkencore nëpërmjet Klinikës Ligjore dhe Kërkimore me qëllim ndërgjegjësimin e kandidatëve për magjistratë për çështje të tilla, si: motivimi, argumentimi, transparenca dhe shteti i së drejtës. Duke bërë punë kërkimore ligjore krahasuese të gjerë dhe veçanërisht për çështjet e të drejtave të njeriut që janë pezull përpara institucioneve të drejtësisë, brezi i ri i gjyqtarëve dhe prokurorëve do të prezantohet me një kulturë të re të argumentimit dhe motivimit ligjor. Për rrjedhojë, është e pritshme që kandidatët për magjistratë të fusin këtë kulturë në gjykatat dhe prokuroritë ku do të punojnë në të ardhmen. Krahas kësaj, kjo Klinikë do të vazhdojë të ketë një ndikim pozitiv në cilësinë (përsa i përket motivimit dhe argumentimit) e institucioneve kyçe të sistemit gjyqësor në vendin tonë. Ky ndikim pozitiv do të jetë rezultat jo vetëm i konsulencës që do të marrin institucionet nga kandidatët për magjistratë, por edhe nga trajnimi që do të kenë stafi mbështetës i këtyre institucioneve gjatë kohës së projektit. Ky kurs do të kontribuojë në konsolidimin e profilit të Shkollës si një institucion kyç në edukimin ligjor, që kombinon edukimin profesional me kërkimin akademik.
- l) Përgatitjen e teksteve dhe cikleve të leksioneve me grupe autorësh dhe shtimin e botimeve nga ana e ekspertëve të Shkollës.

- m) Pasurimi i mëtejshëm i Bibliotekës Digjitale me tituj të botuar nga Shkolla e Magjistraturës ndër vite.
- n) Përmirësimin e Forumit të Shkollës së Magjistraturës dhe rritjen e aktivitetit të tij.

2.5 Për avancimin e Teknologjisë së Informacionit

Në zbatim të VKM-në datë 2.12.2020, “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë”, organ që vepron pranë KLGJ-së, Shkolla e Magjistraturës ka një rol aktiv në vendimmarrjen e Qendrës si pjesë e Bordit Drejtues të saj.

Në bashkëpunim me këtë qendër për miratimin e dokumentacionit për standardizimin e teknologjisë së informacionit, SHM do të vijojë punën për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit elektronik të menaxhimit të veprimtarisë akademike (SMVSHM), e cila do të kapërcejë vështirësitë operationale dhe do të jetë një hap tjetër drejt transformimit digjital të të gjitha shërbimeve.

Sistemi do të ofrojë automatizim më të lartë dhe do të mbështesë rrjedhën e punës brenda institucionit, duke synuar rritjen e efikasitetit të punës, aksesit të aplikantëve për t’u regjistruar në SHM, si dhe të kandidatëve që ndjekin Programin e Formimit Fillestar, stafit pedagogjik dhe administrativ, gjyqtarëve, prokurorëve, ndihmësve ligjorë, kancelarëve, këshilltarëve, avokatëve të shtetit etj., në programet e SHM-së, transparencës, raportimit statistikor si dhe llogaridhënies. Gjithashtu, sistemi do të ndihmojë edhe për komunikimin dhe ndërveprimin ndërmjet institucioneve të drejtësisë, të tillë si Këshilli i Lartë i Gjyqësorit dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Prioritet do të jetë edhe sigurimi i të gjitha pajisjeve hardware që do të nevojiten për SMVSHM dhe qëndërzimin e infrastrukturës së serverëve, si dhe kërkesat e sigurisë së sistemit si program kompjuterik (software).

Në sektorin e Teknologjisë së Informacionit synohet të përmirësohet rrjeti kompjuterik dhe infrastruktura duke kaluar në infrastrukturën Cloud, si infrastrukturë që mbështet të gjitha zhvillimet teknologjike të së ardhmes edhe në fushën e sigurisë kibernetike. Gjithashtu do të zëvendësohen të gjitha pajisjet kompjuterike dhe ato të teknologjisë së informacionit në mbështetje të zhvillimeve teknologjike, programeve të reja dhe sigurisë kibernetike. Kjo e fundit, në bazë të ligjit nr.25/2024, “Për sigurinë kibernetike”, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 531, datë 25.9.2025 kërkon pajisje cilësore në infrastrukturën informatike dhe eliminimin e sistemeve që iu ka përfunduar cikli i jetës. Mbrojtja kibernetike është një ndër prioritet kryesorë të Shkollës.

Gjatë vitit akademik të ardhshëm do të kryhen kurse të vazhdueshme në drejtim të ndërgjegjësimit të stafit akademik dhe administrativ të Shkollës në lidhje me sigurinë kibernetike dhe rregullat që kanë të bëjnë me parandalimin dhe administrimin e incidenteve kibernetike.

Sektori i Teknologjisë dhe Informacionit i Shkollës do të implementojë politika për kontrollin dhe mbrojtjen e aksesit në rrjetet dhe sistemet e informacionit.

Një prioritet i rëndësishëm për Shkollën do të vijojë të jetë rritja e vizibilitetit, jo vetëm për të pasqyruar aktivitetet e Shkollës në funksion të parimit të transparencës dhe informimit, por edhe për të rritur interesin dhe për të forcuar besimin e publikut për Shkollën e Magjistraturës. Gjithashtu, për programin e trajnimit vazhdues, do të sigurohen disa laptop të cilët do të jenë të lidhur me sistemin audio viziv të sallës së trajnimeve për të lehtësuar punën në grupe të pjesëmarrësve në trajnime.